



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo



Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency

DATË/A	31.03.2026
PËR/ZA/TO:	Komisioni për Arsim, Shkencë dhe Teknologji i Kuvendit të Kosovës
NGA/OD/FROM	Prof. Hasnije Ilazi, Kryetare e KShC-së
PERMES	Naim Gashi, Drejtor i Përgjithshëm Agjencia e Kosovës për Akreditim
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raporti i Punës së KShC-së dhe AKA-së për vitin 2025

RAPORTI VJETOR I PUNËS SË KËSHILLIT SHTETËROR TË CILËSISË DHE I AGJENCISË SË KOSOVËS PËR AKREDITIM PËR VITIN 2025

Prishtinë, mars 2026



AKA | Qendra e Studentëve, 10000 Prishtinë, Kosovë
Tel. +383 38 200 65 753 | <https://akreditimi.rks-qov.net/>



Përmbajtja

Shkurtesat	5
1. Hyrje.....	6
2. Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA).....	7
2.1. Misioni dhe qëllimet e AKA-së.....	8
2.2. Anëtarësimet dhe partneritetet	9
2.3. Zhvillimi i kuadrit rregullativ dhe dokumenteve institucionale të AKA-së.....	10
2.3.1. Udhëzimi Administrativ (MASHTI) Nr. 01B-2195.....	11
2.3.2. Rregullore për punën e Komisionit të Ankesave	11
2.3.3. Rregullore për Organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës 12	
2.3.4. Rregullore për Përzgjedhjen, angazhimin dhe kompensimin e ekspertëve të jashtëm 12	
2.3.5. Rregullore për Manualin e akreditimit/riakreditimit dhe validimit	13
2.3.7. Rregullore për Organizimin dhe funksionimin e Këshillit Shtetëror të Cilësisë	14
2.3.8. Rregullore për Standardet e Programeve të Studimit të Doktoratës	14
2.3.9. Rregullore për Monitorim dhe Procedura Pas-akredituese të AKA-së	14
2.4. Dokumente të politikave dhe dokumente mbështetëse institucionale të AKA-së ..	15
2.5 Politikat për Sigurimin e brendshëm të cilësisë së AKA	15
3. Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KShC)	17
3.1. Mbledhjet dhe vendimet e KShC-së.....	18
3.2. Aprovohet Strategjia e Agjencisë së Kosovës për Akreditim 2026–2030	20
3.3 Organizimi i punëtorive për hartimin e Strategjisë së AKA-së.....	21
3.4 Takimi i rregullt vjetor me drejtuesit e institucioneve të arsimit të lartë	21
3.5 Vizitat e KSHC-së dhe takimet me IAL.....	22
3.6 Aprovimi i Planit të Aktiviteteve	22
4. Procesi i vlerësimit dhe akreditimit të IAL-ve për vitin 2025	23
5. Komisioni i Ankesave (KA)	31
5.1. Baza ligjore e funksionimit	31
5.2. Përmbledhje.....	31
5.3. Përbërja e Komisionit të Ankesave.....	31
5.4. Aktiviteti i Komisionit të Ankesave gjatë vitit 2025.....	32
5.5. Mbledhjet e Komisionit të Ankesave	33

5.6. Vendimmarrja e Komisionit të Ankesave.....	34
5.7. Seancat dëgjimore	34
5.8. Vlerësim i përgjithshëm i punës së Komisionit.....	35
6. Zhvillimet institucionale dhe aktivitetet kryesore të Agjencisë	35
6.1. Njohja ndërkombëtare e AKA-së dhe arritjet strategjike	35
6.1.1. Regjistrimi i AKA-së në Regjistrin Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (EQAR).....	35
6.1.2. Takimi me përfaqësues të CHEA-së për mundësinë e anëtarësimit të AKA-së	37
6.1.3. Vlerësimi i Komisionit Evropian për sistemin e sigurimit të cilësisë në Kosovë	38
6.1.4. Publikimi i analizës tematike.....	38
6.2. Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe përfaqësimi i AKA-së në rrjetet dhe forumet e sigurimit të cilësisë.....	39
6.2.1. Pjesëmarrja e AKA-së në seminarin e ENQA-së në Madrid.....	39
6.2.2. Prezantimi i përvojës së AKA-së në asamblenë e përgjithshme të ENQA-së në Qipro	40
6.2.3. Prezantimi i praktikave të AKA-së për procedurat pas-akredituese në rrjetin CEENQA	40
6.2.4. Prezantimi i përvojës së AKA-së në takimin e RCC-së në Kroaci	41
6.2.5. Shkëmbimi i përvojave me Kroacinë për programet e përbashkëta dhe të dyfishta të studimit.....	41
6.2.6. Vizitë institucionale e AKA-së në Universitetin Rikkyo në Japoni.....	42
6.2.7. Konferenca Vjetore e ATMAE-së në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.....	42
6.2.8. Bashkëpunimi me Ambasadën e ShBA-së në mbështetje të zhvillimit të sigurimit të cilësisë	43
6.2.9. Bashkëpunimi me Maqedoninë e Veriut në fushën e sigurimit të cilësisë.....	43
6.2.10. Pjesëmarrja në punëtorinë e ENQA-së për inteligjencën artificiale në Estoni	44
6.2.13. Konferenca ndërkombëtare për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë në Kroaci	45
6.3. Bashkëpunimi me institucionet e arsimit të lartë dhe aktivitetet e AKA-së në Kosovë	45
6.3.1. Mbledhja vjetore e AKA me drejtuesit e institucioneve të arsimit të lartë.	46
6.3.2. Konferenca vjetore ndërkombëtare e AKA-së për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë	46
6.3.3. Vizitat informuese në institucionet e arsimit të lartë	47
6.3.4. Takimi informues me institucionet e arsimit të lartë për procedurat pas-akredituese	47
6.4. Zhvillimi i kuadrit rregullativ, politikave dhe kapaciteteve institucionale.....	48

6.4.1.	Konsultime publike për hartimin dhe përmirësimin e akteve rregullative të AKA-së	48
6.4.2.	Përmirësimi i kornizës rregullative dhe etike për funksionimin e AKA-së	48
6.4.3.	Dëgjimi publik për rishikimin e standardeve të studimeve të doktoratës ...	49
6.4.4.	Punëtorja për hartimin e Strategjisë së AKA-së.....	49
6.4.5.	Forcimi i integritetit institucional dhe transparencës në proceset e sigurimit të cilësisë	50
6.4.6.	Miratimi i Politikave të Privatësisë	50
6.4.7.	Plani i zhvillimit profesional të stafit të AKA-së (2026–2028).....	51
6.4.8.	Zhvillimi i ueb-faqes së re të AKA-së në bashkëpunim me Agjencinë ADA	51
6.4.9.	Trajnimi i institucioneve të arsimit të lartë për përdorimin e platformës digjitale	52
6.4.10.	Partneriteti dhe përkrahja nga donatorët.....	52
7.	SFIDAT DHE PRIORITETET.....	53
7.1.1	Sfida kryesore të AKA-së në vitin 2025 – Buxheti	53
7.2.1.	Implementimi i Rekomandimeve të EQAR.....	53
7.2.2.	Implementimi i Strategjisë së AKA-së 2026-2030	54
8.	Referencat.....	56

Shkurtesat

ADA – Agjencia Austriake për Zhvillim

AKA - Agjencia e Kosovës për Akreditim

CEENQA - Rrjeti i Evropës Qendrore dhe Lindore për Sigurimin e Cilësisë

CHEA – Këshilli për Akreditimin e Arsimit të Lartë

ENQA - Rrjeti Evropian për Sigurimin e Cilësisë

EQAR - Regjistri Evropian për Sigurimin e Cilësisë

ESG - Standardet dhe Udhëzuesit Evropian për Sigurimin e Cilësisë

IAL - Institucion i Arsimit të Lartë

IAL publik - Institucionet e Arsimit të Lartë të financuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës

IAL privat - Institucionet e Arsimit të Lartë të vet-financuara

INQAAHE - Rrjeti Ndërkombëtar i Agjencive për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë

KA - Komisioni i Ankesave i cili shqyrton ankesat e pranuar nga IAL për vendimet e KShC-së

KKK – Korniza Kombëtare e Kualifikimeve

KShC - Këshilli Shtetëror i Cilësisë

Ligji për AL - Ligji për Arsimin e Lartë

MASHTI - Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit

PZR - Plani i Zbatimit të Rekomandimeve

RVV – Raporti i Vetëvlerësimit

SC - Sigurimi i Cilësisë

UA - Udhëzim Administrativ

KSAC – Kodi i fushave të Studimit për Kosove (Kosovo Subject Area Code)

1. Hyrje

Ky raport vjetor paraqet një pasqyrë të përgjithshme të aktiviteteve, proceseve dhe zhvillimeve institucionale të Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për vitin 2025. Raporti synon të ofrojë informacion të strukturuar mbi funksionimin e sistemit të sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë në Republikën e Kosovës, duke reflektuar proceset kryesore të vlerësimit/akreditimit, vendimmarrjen, dhe zhvillimet që kanë karakterizuar punën e Agjencisë gjatë periudhës raportuese.

Në këtë dokument paraqiten aktivitetet dhe vendimet e Këshillit Shtetëror të Cilësisë (KShC), si organi më i lartë vendimmarrës i AKA-së, aktivitetet administrative dhe profesionale të AKA-së, si dhe puna e Komisionit të Ankesave në trajtimin e çështjeve që lidhen me proceset e akreditimit dhe sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë.

Raporti pasqyron gjithashtu zhvillimet institucionale, anëtarësimet ndërkombëtare, përmirësimin e kuadrit rregullativ dhe forcimin e bashkëpunimit me institucionet e arsimit të lartë dhe partnerët ndërkombëtarë. Këto zhvillime kanë kontribuar në avancimin e mekanizmave të sigurimit të cilësisë dhe në harmonizimin e sistemit të arsimit të lartë në Kosovë me standardet dhe praktikat evropiane dhe ndërkombëtare.

Në mënyrë më të detajuar, raporti përfshin:

1. Proceset e vlerësimit / akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë dhe programet e tyre të studimit të nivelit të V-të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (KKK), Bachelor, Master dhe Doktoratës, për vitin 2025;
2. Aktivitetet dhe zhvillimet që kontribuojnë në sigurimin e brendshëm të cilësisë së punës së AKA-së dhe funksionimin e Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si institucion vendimmarrës i AKA-së;
3. Zhvillimet që mundësuan rianëtarësimin e AKA-së në Regjistrin Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (EQAR), si dhe progresin drejt anëtarësimin në Asociacionin Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA);
4. Orientimin strategjik për zgjerimin e bashkëpunimit dhe integrimin e AKA-së në rrjetet e akreditimit në Shtetet e Bashkuara, përfshirë Këshillin për Akreditimin e Arsimit të Lartë (Council for Higher Education Accreditation – CHEA).
5. Bashkëpunimin me institucione partnere kombëtare dhe ndërkombëtare.

2. Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA)

Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA) u themelua nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) në vitin 2008, në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës. Që nga viti 2023, Agjencia e Kosovës për Akreditim funksionon me Ligjin Nr. 08/L-110 për AKA-në dhe ka status të agjencisë rregullatore për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë në Republikën e Kosovës.

AKA realizon proceset e akreditimit, riakreditimit, validimit dhe monitorimit të institucioneve publike dhe private të arsimit të lartë në Kosovë dhe programeve të tyre të studimit. Përmes procesit të akreditimit, AKA mbështet zhvillimin dhe ngritjen e vazhdueshme të cilësisë në arsimin e lartë dhe në këtë mënyrë siguron se ofertat për arsim të lartë në Kosovë përkojnë me standardet e krahasueshme ndërkombëtare.

Baza ligjore për aktivitetin e AKA-së (AKA) janë Ligji për Arsimin e Lartë në Kosovë¹ (Nr. 04/L-037, datë 31.08.2011) dhe Ligji Nr. 08/L-110 për AKA-në², si dhe aktet nënligjore dhe rregulloret e miratuara nga AKA. Që nga themelimi i saj, AKA në përputhje me Standardet dhe Udhëzuesit Evropian për Sigurimin e Cilësisë (ESG)³ ka zhvilluar të gjitha standardet dhe procedurat për akreditim dhe i ka publikuar ato përmes ueb faqes së saj zyrtare.⁴

Proceset kryesore të sigurimit të jashtëm të cilësisë që realizohen nga AKA përfshijnë:

- akreditimin dhe riakreditimin e institucioneve të arsimit të lartë;
- akreditimin dhe riakreditimin e programeve të studimit;
- akreditimin e degëve ku ofrohen programe të studimit;
- njohjen ose validimin e akreditimeve ndërkombëtare;
- procedurat monitoruese dhe pas-akredituese.

Me qëllim të zhvillimit të një procesi transparent të akreditimit, AKA ofron dokumentet e nevojshme mbi procedurat e akreditimit të cilat mund të shfrytëzohen nga IAL-të, si në vijim: Rregulloret dhe Standardet e AKA-së, Udhëzuesit e AKA-së për Hartimin e Raportit të Vetëvlerësimit (RVV) për

¹ [Ligji për Arsimin e Lartë](#).

² [Ligji për Agjencinë e Kosovës për Akreditim](#).

³ [Standardet dhe Udhëzuesit Evropian për Sigurimin e Cilësisë](#).

⁴ [Udhëzuesit për Akreditim](#).

vlerësimin e institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të tyre të studimit, si dhe Rregulloren e Manualit të Akreditimit⁵. Këto dokumente shërbejnë si udhëzues për institucionet e arsimit të lartë gjatë procesit të akreditimit, si dhe për sigurimin dhe menaxhimin e brendshëm të cilësisë.

Struktura organizative e AKA-së përfshin strukturën administrative të udhëhequr nga Drejtori i Përgjithshëm, Këshillin Shtetëror të Cilësisë (KShC) si organin qeverisës dhe vendimmarrës të Agjencisë, si dhe Komisionin e Ankesave, i cili është përgjegjës për shqyrtimin e ankesave.

2.1. Misioni dhe qëllimet e AKA-së

Misioni AKA është të mbështesë zhvillimin dhe ngritjen e vazhdueshme të cilësisë në institucionet e arsimit të lartë përmes procesit të vlerësimit të jashtëm dhe të sigurojë shoqërinë e Kosovës se cilësia e arsimit të lartë është në nivelin e standardeve më të larta ndërkombëtare.

Në bazë të Planit Strategjik 2026-2030 objektivat e AKA-së janë si vijon:

1. Zhvillimi i AKA-së si institucion që pasqyron profesionalizëm të lartë dhe standarde etike në proceset e sigurimit të cilësisë në Kosovë.
2. Avancimi i praktikave të sigurimit të cilësisë për përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë në sektorin e arsimit të lartë në Kosovë.
3. Ndërkombëtarizimi i sistemit të sigurimit të cilësisë dhe shfrytëzimi i tij për të avancuar praktikat institucionale dhe ato në nivel sistemi.
4. Promovimi i kulturës së cilësisë në arsimin e lartë në Kosovë përmes vetëdijesimit individual dhe institucional, zhvillimit të kapaciteteve dhe praktikave të institucionalizuara.

Vlerat kryesore në të cilat mbështetet puna e AKA-së janë:

Puna e AKA-së dhe mekanizmave të sigurimit të jashtëm të cilësisë që ajo menaxhon, mbështetet në një sërë vlerash që pasqyrojnë angazhimin dhe misionin e saj. Më poshtë paraqiten vlerat kryesore që udhëheqin punën e AKA-së:

Integriteti: pasqyron angazhimin e AKA-së dhe strukturave të saj që proceset e vlerësimit dhe vendimmarrjes të zhvillohen me ndershmëri, objektivitet dhe qëndrueshmëri, duke siguruar që gjykimet të bazohen në të dhëna dhe dëshmi të verifikuara dhe të jenë tërësisht të lira nga konfliktet

⁵ [Standardet e Akreditimi.](#)

e interesit, paragjykimet apo ndikime të tjera. Kjo nënkupton një nivel të lartë profesionalizmi në punën e AKA-së dhe përmirësim të vazhdueshëm të saj për të rritur besimin dhe cilësinë e rezultateve.

Transparenca: nënkupton komunikim të hapur dhe të qasshëm lidhur me proceset, kriteret, vendimet dhe rezultatet që kanë të bëjnë me vlerësimin dhe akreditimin e institucioneve apo programeve. Në mënyrë më specifike, kjo nënkupton nevojën që standardet të jenë jo vetëm transparente, por edhe të qarta dhe të paanshme, duke shmangur interpretimet e shumëfishta apo paqartësitë.

Pavarësia: i referohet parimit që AKA i ndërmerr vendimet, vlerësimet dhe gjykimet në mënyrë autonome dhe të lirë nga presionet politike, financiare apo institucionale. Kjo synon të sigurojë besueshmëri, drejtësi dhe integritet në procesin e sigurimit të cilësisë në Kosovë. Ky parim lidhet gjithashtu me autonominë organizative dhe qeverisjen e AKA-së, duke e mbajtur të lirë nga ndërhyrjet politike apo ato të grupeve të interesit.

Profesionalizmi: nënkupton sjellje kompetente, etike dhe të përgjegjshme nga të gjithë individët dhe institucionet e përfshira në proceset e sigurimit të cilësisë, qoftë nga ana e AKA-së apo e institucioneve të arsimit të lartë. Ai siguron që vlerësimet të kryhen me ekspertizë, respekt dhe përkushtim ndaj standardeve të larta të praktikës dhe kuptimit më të mirë të standardeve dhe kriterëve. Nga ana tjetër, AKA mbetet e përkushtuar ndaj zhvillimit të mëtejshëm të kapaciteteve dhe kompetencave të të gjithë individëve që punojnë brenda dhe me AKA-në.

Gjithëpërfshirja dhe diversiteti: i referohen njohjes aktive, respektimit dhe përfshirjes së perspektivave, prejardhjeve dhe grupeve të ndryshme të palëve të interesit në hartimin, zbatimin dhe proceset e vlerësimit. Kjo përfshin respektimin dhe adresimin e barazisë gjinore në të gjitha shërbimet dhe aktivitetet, përfshirjen e grupeve minoritare dhe atyre të marginalizuara, si dhe përfshirjen e perspektivave të të gjitha palëve të interesit në hartimin e politikave dhe praktikave.

Përgjegjësia shoqërore: i referohet angazhimit që proceset e AKA-së të kontribuojnë pozitivisht në shoqëri, duke siguruar që arsimit të lartë promovon të mirën publike, sjelljen etike dhe zhvillimin shoqëror.

2.2. Anëtarësimet dhe partneritetet

Gjatë vitit 2025, Agjencia e Kosovës për Akreditim ka shënuar një nga arritjet më të rëndësishme në zhvillimin e saj institucional me ri-regjistrimin në Regjistrin Evropian për Sigurimin e Cilësisë në

Arsimin e Lartë (EQAR) ⁶. Ky regjistrim u realizua pas një vlerësimi pozitiv nga një panel i pavarur ekspertësh të Asociacionit Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA), duke konfirmuar se AKA operon në përputhje me Standardet dhe Udhëzimet Evropiane për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ESG). Kosova aktualisht është vendi i vetëm në Ballkanin Perëndimor që është e regjistruar në EQAR. Me këtë status, AKA ka të drejtë të bëjë akreditime të universiteteve dhe programeve të studimit në gjithë Evropën.

Përveç në EQAR, AKA vazhdon të jetë pjesë e rrjeteve ndërkombëtare për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë dhe gjatë vitit 2025 është anëtare e:

- Rrjetit të Agjencive për Sigurimin e Cilësisë në Evropën Qendrore dhe Lindore (CEENQA)⁷;
- Rrjetit Ndërkombëtar të Agjencive për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (INQAAHE)⁸;
- ENQA Affiliate: AKA ka arritur që të marrë statusin ENQA Affiliate, pas plotësimit të një varg kriteresh të cilat janë verifikuar nga Bordi i ENQA dhe më pas janë aprovuar nga Asambleja e ENQA në Stokholm.⁹;
- Global Academic Integrity Network (GAIN)¹⁰: Rrjeti Global i Integritetit Akademik është një konsorcium agjencish që promovojnë integritetin akademik dhe bashkëpunojnë për të adresuar fenomenin e mashtrimit akademik dhe shërbimeve tregtare që cenojnë integritetin në arsimin e lartë;

Përmes këtyre anëtarësimeve dhe partneriteteve ndërkombëtare, AKA kontribuon në shkëmbimin e përvojave dhe në zhvillimin e mëtejshëm të praktikave të sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë.

2.3. Zhvillimi i kuadrit rregullativ dhe dokumenteve institucionale të AKA-së

Si rezultat i aprovimit të Ligjit për AKA në vitin 2023, gjatë vitit 2024 dhe 2025 është avancuar më tej kuadri rregullativ i AKA-së përmes miratimit të një sërë aktesh nënligjore dhe dokumentesh institucionale që mbështesin funksionimin dhe zhvillimin e agjencisë dhe ofrojnë bazë për procedurat akredituese. Funksionimi dhe performanca e AKA ndikohen drejtpërdrejt nga ky kuadër ligjor, i cili përfshin Ligjin për AKA-në, udhëzimet administrative dhe rregulloret që rregullojnë proceset e vlerësimit, akreditimit dhe menaxhimit të brendshëm të AKA-së.

⁶ [The European Quality Assurance Register for Higher Education \(EQAR\).](#)

⁷ [Central and Eastern European Network of Quality Assurance Agencies in Higher Education \(CEENQA\).](#)

⁸ [The International Network for Quality Assurance Agencies in Higher Education \(INQAAHE\).](#)

⁹ [ENQA Affiliate.](#)

¹⁰ [Global Academic Integrity Network \(GAIN\).](#)

2.3.1. Udhëzimi Administrativ (MASHTI) Nr. 01B-2195

Bazuar në Ligjin për AKA-në, respektivisht në nenin 28 të këtij ligji që rregullon *kriteret, standardet dhe procedurat e akreditimit*, dhe në pikën 10 të këtij neni, e cila i referohet bartësve të programeve sipas paragrafit 9 për programet studimore nga radhët e komuniteteve joshumicë, Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) ka nxjerrë Udhëzimin Administrativ Nr. 01B-03/20 për vlerësimin e përshtatshmërisë së bartësve të programeve studimore, si dhe të programeve nga radhët e komuniteteve joshumicë në procesin e akreditimit dhe riakreditimit të institucioneve të arsimit të lartë.

Bazuar në legjislacionin e lartpërmendur, programet e studimit nga radhët e komuniteteve joshumicë do të përfitojnë lehtësira në procesin e akreditimit dhe në zhvillimin e programeve në gjuhët e tyre, duke filluar nga viti akademik 2024–2025. Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ është vlerësimi i përputhshmërisë së bartësve të programeve studimore për të cilat institucionet e arsimit të lartë aplikojnë në procesin e akreditimit dhe riakreditimit, duke përfshirë edhe programet nga radhët e komuniteteve joshumicë.

Ky Udhëzim Administrativ zbatohet nga Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA) për të gjitha programet e studimit nga radhët e komuniteteve joshumicë që aplikojnë për akreditim dhe riakreditim. Zbatimi i tij synon promovimin e vlerave të përcaktuara në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, në Ligjin për Arsimin e Lartë dhe në Ligjin për AKA-në, të cilat mbështesin dhe promovojnë të drejtat e komuniteteve joshumicë.

2.3.2. Rregullore për punën e Komisionit të Ankesave

Rregullorja për Punën e Komisionit të Ankesave¹¹ të AKA përcakton strukturën, funksionet dhe procedurat e këtij organi. Komisioni i Ankesave trajton ankesat e institucioneve të arsimit të lartë ndaj vendimeve të Këshillit Shtetëror të Cilësisë (KShC), duke siguruar një proces të drejtë dhe transparent në vlerësimin e këtyre ankesave.

Procedurat e punës së Komisionit përfshijnë afatet kohore për parashtrimin dhe shqyrtimin e ankesave, mënyrën e mbledhjes së provave dhe marrjen e vendimeve. Gjithashtu, rregullorja përcakton se vendimet e Komisionit janë përfundimtare brenda AKA-së, duke garantuar efikasitetin në trajtimin e çështjeve të ngritura nga institucionet e arsimit të lartë.

¹¹ [Rregullore për punën e Komisionit të Ankesave](#).

2.3.3. Rregullore për Organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës

Bazuar në këtë rregullore dhe organogramin e ri, AKA ka një strukturë profesionale organizative, në harmoni të plotë me Standardet dhe Udhëzuesit Evropianë (ESG), në harmoni me Ligjin e ri të AKA-së si dhe me legjislacionin e Kosovës në përgjithësi.

Struktura e re e AKA-së përbëhet nga dy departamente, gjashtë divizione dhe njësitë e tjera mbështetëse. Staf i aprovuar i AKA-së do të jetë 32. Kjo Rregullore krijon një strukturë të qartë organizative, duke përmirësuar efikasitetin operacional të AKA, duke siguruar një përshkrim të qartë të detyrave dhe përgjegjësi, në mënyrë që të rritet profesionalizmi.¹²

2.3.4. Rregullore për Përzgjedhjen, angazhimin dhe kompensimin e ekspertëve të jashtëm

Rregullorja për Përzgjedhjen, Angazhimin dhe Kompensimin e Ekspertëve të Jashtëm¹³ në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) përcakton kriteret dhe procedurat për përzgjedhjen e ekspertëve që marrin pjesë në procesin e vlerësimit të institucioneve të arsimit të lartë. Ajo siguron që ekspertët e jashtëm të jenë profesionistë me përvojë relevante akademike dhe në fushën e cilësisë, duke garantuar një proces vlerësimi të paanshëm dhe të besueshëm.

Procesi i përzgjedhjes realizohet përmes një thirrjeje publike, përmes kriterëve të caktuara për kualifikimin akademik dhe përvojën profesionale. Përzgjedhja e ekspertëve bëhet nga KShC, duke u bazuar në transparencë dhe meritokraci. Ekspertët e përzgjedhur angazhohen për periudha të caktuara dhe duhet të respektojnë standardet etike dhe profesionale gjatë vlerësimit të institucioneve dhe programeve akademike.

Kompensimi i ekspertëve të jashtëm është i përcaktuar në rregullore, duke marrë parasysh kompleksitetin e vlerësimeve dhe kohën e angazhimit të tyre. Pagesat bëhen në përputhje me dispozitat financiare të AKA-së, duke siguruar shpërblim të drejtë për kontributin e ekspertëve në procesin e akreditimit. Gjithashtu, rregullorja parashikon detajet për mbulimin e shpenzimeve dhe parimet mbi konfliktin e interesit për të ruajtur integritetin e procesit të vlerësimit.

¹² [Rregullore për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të punës.](#)

¹³ [Rregullore për Përzgjedhjen, Angazhimin dhe Kompensimin e Ekspertëve të Jashtëm.](#)

2.3.5. Rregullore për Manualin e akreditimit/riakreditimit dhe validimit

Rregullorja është një dokument kyç që përcakton standardet dhe procedurat për akreditimin, riakreditimin dhe validimin e institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të tyre në Kosovë. Kjo rregullore është hartuar në përputhje me Standardet dhe Udhëzuesit Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë (ESG), duke synuar përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së institucioneve arsimore në vend.

Në qershor 2025, Këshilli Shtetëror i Cilësisë miratoi versionin e përditësuar të Manualit të Akreditimit, në kuadër të Rregullores (AKA) Nr. 04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit¹⁴, me qëllim të reflektimit të zhvillimeve të reja në proceset e vlerësimit dhe harmonizimit të mëtejshëm me praktikat evropiane të sigurimit të cilësisë.

Rregullorja shërben si udhërrëfyes për AKA, institucionet e arsimit të lartë, ekspertët ndërkombëtarë dhe publikun e përgjithshëm në zbatimin e procedurave të drejta dhe transparente të akreditimit. Ajo përcakton përgjegjësitë kryesore të institucioneve arsimore për sigurimin e cilësisë së shërbimeve që ofrojnë, duke marrë parasysh diversitetin e sistemeve arsimore, institucioneve, programeve dhe studentëve. Gjithashtu, rregullorja inkurajon zhvillimin e kulturës së cilësisë dhe merr parasysh nevojat dhe pritshmëritë e studentëve, akterëve të tjerë dhe shoqërisë në përgjithësi.

Rregullorja përmban kritere të qarta për vlerësimin e institucioneve dhe programeve studimore.

2.3.6. Rregullore për Procedurat dhe Kriteret për Vlerësim të Jashtëm nga Agjencitë Ndërkombëtare të Akreditimit

Kjo Rregullore njihet ndryshe edhe si Rregullorja për Validim¹⁵. Kjo rregullore përcakton procedurat dhe kriteret e validimit në rastet kur një institucion i arsimit të lartë aplikon për vlerësim të jashtëm në nivel institucional apo për programe studimi nga një agjenci ndërkombëtare e akreditimit.

Gjithashtu, Rregullorja për Validim mbulon rastet kur një institucion i arsimit të lartë, i akredituar nga AKA, në partneritet me një universitet ndërkombëtar, vendos të ofrojë në Kosovë programe studimi të cilat, në vendin e origjinës, janë të akredituara nga agjenci ndërkombëtare të akreditimit.

¹⁴ [Rregullorja për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Bachelori dhe Master.](#)

¹⁵ [Rregullore për per Validim.](#)

2.3.7. Rregullore për Organizimin dhe funksionimin e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

Kjo rregullore ¹⁶ përcakton strukturën, kompetencat dhe mënyrën e funksionimit të Këshillit Shtetëror të Cilësisë (KShC), si organi më i lartë vendimmarrës në Agjencinë e Kosovës për Akreditim. Rregullorja definon procedurat e mbledhjeve të Këshillit, mënyrën e vendimmarrjes, detyrat dhe përgjegjësitë e anëtarëve si dhe raportin institucional ndërmjet KShC dhe strukturave administrative të AKA-së. Përmes kësaj rregulloreje synohet të sigurohet një proces vendimmarrës transparent, profesional dhe në përputhje me standardet evropiane për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë.

2.3.8. Rregullore për Standardet e Programeve të Studimit të Doktoratës

Kjo rregullore ¹⁷ përcakton standardet dhe kriteret për akreditimin dhe zhvillimin e programeve të studimeve të doktoratës në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Kosovës. Dokumenti definon kërkesat minimale lidhur me strukturën akademike të programeve PhD, kualifikimin e stafit akademik, infrastrukturën kërkimore, si dhe mekanizmat për sigurimin e cilësisë si dhe funksionimin e studimeve të doktoratës. Qëllimi i kësaj rregulloreje është harmonizimi i programeve të doktoraturës në Kosovë me praktikën evropiane të arsimit të lartë dhe forcimi i dimensionit kërkimor në institucionet akademike.

2.3.9. Rregullore për Monitorim dhe Procedura Pas-akredituese të AKA-së

Kjo rregullore ¹⁸ përcakton procedurat dhe kriteret për monitorimin e institucioneve të arsimit të lartë pas marrjes së vendimit për akreditim. Dokumenti definon mekanizmat për vazhdimin/përfundimin e implementimit të rekomandimeve të ekspertëve ndërkombëtarë, procesin e raportimit periodik dhe procedurat për vlerësimin e progresit të institucioneve. Qëllimi i rregullores është forcimi i dimensionit të pas-akreditimit dhe sigurimi i përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë në institucionet e arsimit të lartë.

¹⁶ [Rregullore për Organizimin dhe Funksionimin e Këshillit Shtetëror të Cilësisë.](#)

¹⁷ [Rregullore për Standardet e Programeve të Studimit PhD.](#)

¹⁸ [Rregullore për Monitorim dhe Procedura Pas-Akredituese.](#)

2.4. Dokumente të politikave dhe dokumente mbështetëse institucionale të AKA-së

Përveç akteve nënligjore, gjatë periudhës raportuese AKA ka zhvilluar dhe miratuar edhe një sërë dokumentesh mbështetëse dhe politikash institucionale që synojnë forcimin e qeverisjes së brendshme dhe rritjen e transparencës institucionale. Në këtë kuadër janë hartuar dhe zbatuar dokumente si:

- Strategjia e AKA-së 2026-2030 ¹⁹
- Udhëzuesi për IAL-të për procesin e ankimit në Komisionin e Ankesave ²⁰,
- Manuali për zhvillimin profesional të stafit të ri ²¹,
- Udhëzuesi për procedurat e përgjithshme në Agjencinë e Kosovës për Akreditim ²²,
- Kodi i Etikës për nëpunësit civil të AKA-së ²³,
- Plani i Integritetit i AKA 2025–2027 ²⁴,
- Politika e Privatësisë e AKA-së ²⁵.
- Politikat për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë²⁶.

Këto dokumente kontribuojnë në përmirësimin e funksionimit të brendshëm të agjencisë, promovimin e standardeve etike dhe profesionale, si dhe në rritjen e llogaridhënies dhe besueshmërisë institucionale në proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë.

2.5 Politikat për Sigurimin e brendshëm të cilësisë së AKA

AKA ka hartuar dokumentin Politikat për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, i cili përcakton masat dhe procedurat për të siguruar cilësinë e brendshme brenda agjencisë. Këto politika janë në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe synojnë të rrisin transparencën, llogaridhënien dhe përmirësimin e vazhdueshëm të proceseve të akreditimit.

Politikat për sigurimin e brendshëm të cilësisë së AKA-së vendosin dhe përshkruajnë në mënyrë formale të gjitha veprimet të cilat realizohen me qëllim të zbatimit të sigurimit të brendshëm të cilësisë. Politikat shërbejnë si mekanizëm kryesor i AKA-së për reflektim të brendshëm dhe janë në

¹⁹ <https://akreditimi.rks-qov.net/wp-content/uploads/AKA-Plani-Strategjik-2026-2030-ALB-1.pdf>

²⁰ [Udhëzuesi për IAL-të për procesin e ankimit në Komisionin e Ankesave.](#)

²¹ [Manuali për zhvillimin profesional të stafit të ri.](#)

²² [Udhëzuesi për procedurat e përgjithshme në Agjencinë e Kosovës për Akreditim.](#)

²³ [Kodi i Etikës për nëpunësit civil.](#)

²⁴ [Plani i Integritetit i AKA 2025–2027.](#)

²⁵ [Politika e Privatësisë e AKA-së.](#)

²⁶ [Politikat për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë](#)

përputhje të plotë me angazhimin e AKA-së për vendosjen e një sistemi të funksionimit i cili është i krahasueshëm me agjencitë evropiane të sigurimit të cilësisë.

Përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë në AKA sigurohet duke aplikuar ciklin PDCA (planifiko – bëj – kontrollo – vepro). Planifikimi dhe realizimi me kohë dhe në mënyrë të rregullt i proceseve të vlerësimit të jashtëm përpos që parashihet me legjislacionin në fuqi, është indikator esencial i performancës së AKA-së. Në anën tjetër, mbledhja e të dhënave përmes kontrollimit e monitorimit dhe rishikimi i procedurave të brendshme janë parakusht për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Proceset e vlerësimit të brendshëm kontribuojnë edhe në rritjen e transparencës së veprimeve të AKA-së karshi shoqërisë në përgjithësi. Në këtë drejtim, AKA angazhohet në përfshirjen e akterëve relevantë, informacionet kthyesë të të cilëve shërbejnë si bazë e rëndësishme për informimin e politikave të AKA-së.

3. Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KShC)

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KShC) ose Bordi i AKA-së, është organ vendimmarrës i AKA-së dhe është përgjegjës për marrjen e vendimeve për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të tyre të studimit. Këshilli Shtetëror i Cilësisë punon duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 dhe Ligjin Nr. 08/L-110 për AKA-në²⁷ dhe mbështetet në Rregulloren mbi Punën e Këshillit Shtetëror të Cilësisë (Nr. 02/2025)²⁸.

Legjislacioni në fuqi mundëson përzgjedhjen e anëtarëve të KShC-së mbi bazën e kriterëve dhe procedurave profesionale dhe transparente. Lista e përzgjedhur e të nominuarve ratifikohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Duke u bazuar në Rregulloren e punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, KShC cakton agjendat vjetore për procesin e akreditimit të IAL-ve, aprovon standardet, procedurat dhe kriteret e akreditimit, aprovon ekipet e ekspertëve të jashtëm të propozuara nga drejtori i AKA, merr vendimet për akreditim si dhe aprovon Statutin dhe rregulloret e AKA.

Përbërja e KShC-së në vitin 2025 ishte si në vijim:

1. Prof. Asoc. Dr. Hasnije Ilazi, kryetare;
2. Dr. Klemen Miklavic, nënkryetar;
3. Prof. Ass. Dr. Gëzim Tosuni, anëtar;
4. Prof. Dr. Maja Martinović, anëtare;
5. Prof. Dr. Jaakko Kauko, anëtar;
6. Prof. Dr. Mirlinda Batalli, anëtare;
7. Prof. Dr. Avni Berisha, anëtar;
8. Dr. Jetmir Haxhibeqiri, anëtar,
9. Shkurta Bajgora, studente, anëtare;

Anëtarë pa të drejtë vote:

10. Drejtori i AKA-së, z. Naim Gashi (sipas detyrës);
11. z. Ermal Sadiku, përfaqësues i industrisë dhe
12. znj. Arieta Pozhegu Vula, përfaqësuese e industrisë.

²⁷ [Ligji per Agjencinë e Kosovës për Akreditim.](#)

²⁸ <https://akreditimi.rks-gov.net/wp-content/uploads/RREGULLORJA-AKA-Nr.-022025-PER-ORGANIZIMIN-DHE-FUNKSIONIMIN-E-KESHILLIT-SHTETEROR-TE-CILESISE.pdf>


3.1. Mbledhjet dhe vendimet e KShC-së

Gjatë vitit 2025, KShC ka zhvilluar një sërë aktivitetesh që lidhen me funksionimin e sistemit të sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë në Republikën e Kosovës. Në kuadër të mbledhjeve të rregullta dhe të jashtëzakonshme, KShC ka shqyrtuar raportet e ekspertëve ndërkombëtarë për akreditimin institucional dhe të programeve të studimit, ka trajtuar kërkesat dhe ankesat e institucioneve të arsimit të lartë, si dhe ka miratuar një sërë aktesh rregullative që rregullojnë proceset e akreditimit dhe monitorimit. Gjatë vitit 2025 KSHC ka mbajtur një mbledhje online, që ka qenë vazhdimi i mbledhjes 142, ndërsa një votim është bërë online me email qarkor.

Gjithashtu, gjatë procesit të akreditimeve KShC ka aprovuar panele individuale të ekspertëve ndërkombëtarë për vlerësimin e institucioneve dhe programeve studimore të IAL-ve.

Përveç aktiviteteve që lidhen drejtpërdrejt me procesin e akreditimit, KShC gjatë vitit 2025 ka kontribuar në hartimin dhe e ka aprovuar Strategjinë e AKA 2026-2031 dhe ka kontribuar në organizimin e konferencës ndërkombëtare për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë. Tabela në vijim paraqet në mënyrë kronologjike çështjet kryesore të trajtuara nga KShC gjatë mbledhjeve të zhvilluara në vitin 2025.

Mbledhjet e KShC-së për vitin 2025



10.03.2025

Mbledhja 135

Shqyrtimi i raporteve të ekspertëve dhe miratimi në parim i draft-Rregullores për Monitorim dhe Procedura pas-akredituese; miratimi i Rregullores për Validim

14.04.2025

Mbledhja 136

Shqyrtimi i raporteve të ekspertëve për akreditimin e programeve studimore, përfshirë kthimin e disa raporteve për rivlerësim dhe angazhimin e ekspertëve shtesë.

19.05.2025

Mbledhja 137

Shqyrtimi i raporteve të ekspertëve dhe diskutimi për organizimin e konferencës ndërkombëtare për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë përfshirë përzgjedhjen e panelistëve, moderatorëve dhe agjendën e konferencës

16.06.2025

Mbledhja 138

Diskutim për standardet e programeve për përgatitjen e mësimit të mesimdhënësve, strukturën e programeve master dhe trajtimit të kërkesave dhe ankesave të institucioneve

30.06.2025


Mbledhja 139

Miratimi i Rregullores për Standardet e Vlerësimit të Programeve të Doktoratës dhe Rregullores për Monitorim dhe Procedurat pas-akredituese

24.07.2025

Mbledhja 140

Shqyrtimi i raporteve të ekspertëve dhe diskutimi për progresin e organizimit të konferencës së AKA-së përfshirë përbërjen e panelistëve, listën e të ftuarve dhe aktivitetet tjera



Në përgjithësi, gjatë procesit të akreditimit, KShC ka vlerësuar se, bazuar në vlerësimet e ekspertëve ndërkombëtarë, IAL-të shfaqin mangësi më të theksuara në zbatimin e standardit nr. 3 për Hulumtimin dhe standardit nr. 2 për Menaxhimin e cilësisë. Prandaj, Konferenca vjetore e AKA-së për vitin 2026 do të përqendrohet në cilësinë e brendshme, ndërsa stafi i AKA-së do të organizojë trajnime për zyrtarët e IAL-ve, me qëllim që t'i ndihmojë institucionet në rritjen e cilësisë në kuadër të standardeve të lartpërmendura.

3.2. Aprovohet Strategjia e Agjencisë së Kosovës për Akreditim 2026–2030

Këshilli Shtetëror i Cilësisë në mbledhjen e mbajtur më 1 dhjetor 2025, miratoi Strategjinë e Agjencisë së Kosovës për Akreditim për periudhën 2026–2030.

Dokumenti strategjik përcakton drejtimin e zhvillimit të sistemit të sigurimit të jashtëm të cilësisë në pesë vitet e ardhshme në Republikën e Kosovës, duke reflektuar qartë standardet evropiane, kontekstin e arsimit të lartë në Kosovë dhe vizionin për forcimin e mëtejshëm të besueshmërisë së akreditimit.

Strategjia është e ndërtuar mbi parimet e integritetit, transparencës, profesionalizmit dhe pavarësisë institucionale, të cilat mbeten bazë për gjithë veprimtarinë e AKA-së dhe KSHC-së.

Strategjia 2026–2030 përfshin katër objektiva kryesore zhvillimore: ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe etike të AKA-së; avancimin e praktikave të sigurimit të cilësisë përtej përputhshmërisë, drejt një qasjeje të mirëfilltë të përmirësimit të vazhdueshëm; ndërkombëtarizimin e punës së AKA-së dhe forcimin e prezencës së saj në rrjete evropiane e globale; si dhe promovimin e kulturës së cilësisë në institucionet e arsimit të lartë.

Strategjia parasheh rishikimin periodik të standardeve të akreditimit, zhvillimin e procedurave të reja për programet e përbashkëta dhe mikrokredencialet, digjitalizimin e plotë të proceseve të akreditimit, si dhe integrimin progresiv të inteligjencës artificiale në përpunimin e të dhënave dhe hartimin e raporteve.

Hartimi i Strategjisë së AKA-së është përkrahur nga Programi SHER, i cili financohet nga Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA).

3.3 Organizimi i punëtorive për hartimin e Strategjisë së AKA-së

Para se të miratohet Strategjia, më datën 1 tetor 2025, KShC me përkrahje të programit SHER, organizoi punëtorinë njëditore për finalizimin e draftit të Planit Strategjik të AKA-së 2026–2030.

Punëtorija u organizua me qëllim të përfshirjes së kontributit të të gjithë akterëve relevantë në ndërtimin e këtij dokumenti strategjik të rëndësishëm, i cili do të ndikojë në ngritjen e cilësisë së punës së AKA-së dhe në përmirësimin e cilësisë në arsimin e lartë në Kosovë.

Më datën 26.05.2025 në Prishtinë është mbajtur punëtorija tjetër për hartimin e Strategjisë së AKA 2026-30 në të cilën kanë marrë pjesë përfaqësuesit e institucioneve të arsimit të lartë publikë dhe privatë.

Gjatë punëtorisë, nga AKA janë prezantuar të arriturat në implementimin e Strategjisë së AKA 2021 -2025, ndërsa përfaqësuesit e IAL-ve kanë diskutuar për vizionin dhe objektivat e dokumentit të ri strategjik.

3.4 Takimi i rregullt vjetor me drejtuesit e institucioneve të arsimit të lartë

Më 24 shkurt 2025, KSHC dhe drejtuesit e AKA-së zhvilluan takimin e tyre të rregullt vjetor me përfaqësuesit e institucioneve publike dhe private të arsimit të lartë në Republikën e Kosovës. Ky

takim, i ndarë në dy seanca të veçanta, kishte për qëllim diskutimin e çështjeve kryesore të akreditimit, sigurimit të cilësisë dhe planeve strategjike të AKA-së për të ardhmen.

Në takim morën pjesë rektorë, dekanë dhe udhëheqësit e zyrave të cilësisë të institucioneve të arsimit të lartë (IAL), të cilët u informuan mbi zhvillimet më të fundit në fushën e akreditimit dhe sigurimit të cilësisë. Ky është një aktivitet i përvitshëm, përmes të cilit AKA siguron një dialog të hapur me institucionet akademike për të ndarë përvojat, për të adresuar sfidat dhe për të identifikuar hapat e ardhshëm për përmirësimin e cilësisë në arsimin e lartë.

3.5 Vizitat e KShC-së dhe takimet me IAL

Këshilli Shtetëror i Cilësisë ka krijuar tashmë një traditë të vizitave në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Kosovës. Gjatë vitit 2025 janë vizituar shtatë institucione të arsimit të lartë, ku njëkohësisht janë mbajtur edhe mbledhjet e KShC-së.

Gjatë këtyre vizitave, anëtarët e KShC dhe menaxhmenti i AKA takohen me drejtuesit e IAL-ve, vizitojnë hapësirat e IAL-ve, dhe pastaj zhvillojnë mbledhjen e KShC-së në ambientet e po atyre institucioneve.

Kjo përbën një praktikë evropiane, e cila synon forcimin e bashkëpunimit dhe krijimin e partneriteteve ndërmjet agjencive të akreditimit dhe institucioneve të arsimit të lartë. Përmes këtyre vizitave krijohen mundësi më të mira për komunikim të drejtpërdrejtë, shkëmbim të përvojave dhe adresim të çështjeve me interes për zhvillimin e cilësisë në arsimin e lartë.

Përveç vizitave individuale, përfaqësues të KShC-së dhe menaxhmenti i AKA-së kanë pritur në takime dhjetëra përfaqësues të institucioneve të arsimit të lartë, me të cilët kanë diskutuar tema të ndryshme që lidhen me sigurimin e cilësisë, proceset e akreditimit dhe avancimin e standardeve në arsimin e lartë në vend.

3.6 Aprovimi i Planit të Aktiviteteve

KShC më 17 janar 2025, shqyrtoi dhe aprovoi Planin e Aktiviteteve për vitin 2025. Ky plan paraqet një dokument të rëndësishëm orientues për punën e AKA-së gjatë vitit dhe shërben si udhërrëfyes për zhvillimet strategjike dhe operationale në proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë në Republikën e Kosovës.

Përmes këtij plani përcaktohen prioritetet kryesore të Agjencisë, aktivitetet që do të ndërmerren gjatë vitit, si dhe objektivat që lidhen me avancimin e proceseve të vlerësimit, akreditimit dhe monitorimit

të institucioneve të arsimit të lartë. Plani synon të garantojë një qasje më të strukturuar, më efektive dhe më transparente në ushtrimin e përgjegjësisë të Këshillit.

Po ashtu, Plani i Aktiviteteve për vitin 2025 synon të forcojë bashkëpunimin institucional me akterët relevantë të arsimit të lartë, të mbështesë zbatimin e standardeve të cilësisë dhe të kontribuojë në përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit të arsimit të lartë në vend.

4. Procesi i vlerësimit dhe akreditimit të IAL-ve për vitin 2025

Vlerësimi institucional dhe i programeve të studimit është një aktivitet periodik i AKA-së. Ky proces bazohet në vlerësimin e dokumenteve të dorëzuara nga institucioni aplikues (Raporti i vetëvlerësimit) dhe në bazë të të gjeturave gjatë vizitës në terren me ekipin e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit. Bazuar në procedurat e publikuara të AKA-së, çdo IAL duhet të dëshmojë se plotëson kriteret e akreditimit me qëllim të marrjes së akreditimit.

Bazuar në Ligjin për AKA-në, çdo IAL paraqet kërkesë për akreditim / ri-akreditim institucional, apo të një apo më shumë programeve të studimit. Njëkohësisht IAL duhet të paraqesë edhe listën e stafit akademik, të deklaruar në AKA përmes platformës e-akreditimi për angazhim në po atë IAL, në programin përkatës për vitin përkatës akademik. Aplikacioni, së bashku me listën e stafit i nënshtrohet vlerësimit të përmbushjes së kriterëve formale dhe pas aprovimit nga KShC, ai përfshihet në agjendën vjetore të AKA për vlerësim. Në rast të vlerësimit negativ paraprak të aplikacionit nga KShC, ai refuzohet dhe nuk i nënshtrohet vlerësimit. Përveç aplikacioneve dhe listave të stafit të aprovuara, IAL duhet të sjellë në AKA edhe Raportin e Vetëvlerësimit (RVV) i cili i dërgohet ekipit vlerësues të jashtëm në një afat kohor të caktuar para vizitës fizike.

Në vitin 2025 AKA realizoi procesin e vlerësimit dhe akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të studimit mbi bazën e standardeve të rishikuara në vitin 2024 dhe Rregullores së Manualit të ri të Akreditimit në të cilën duhet të bazohen IAL gjatë hartimit të RVV. Këto standardet synojnë avancimin e cilësisë së përgjithshme të IAL-ve në Kosovë dhe fokusohen në konsolidimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë së tyre.

4.1. Institucionet e arsimit të lartë në Kosovë

Sistemi i arsimit të lartë në Republikën e Kosovës përbëhet nga institucione publike dhe private të që ofrojnë programe studimi në nivelet Bachelor, Master dhe Doktoratë. Këto institucione operojnë në përputhje me legjislacionin në fuqi për arsimin e lartë dhe i nënshtrohen proceseve të akreditimit dhe riakreditimit që realizohen nga AKA. Institucionet e arsimit të lartë në Kosovë përfshijnë universitete, kolegje, akademi, dhe njësi të tjera që zhvillojnë veprimtarinë e tyre në fusha të ndryshme të studimit. Përmes proceseve të vlerësimit dhe akreditimit institucional dhe të programeve të studimit, AKA dhe KShC sigurojnë që këto institucione të përmbushin standardet e përcaktuara për cilësinë në arsimin e lartë. Sistemi i arsimit të lartë në Kosovë përbëhet nga 21 institucione të arsimit të lartë, prej të cilave 10 janë publike dhe 11 private. Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës për vitin 2025, në këto institucione janë të regjistruar gjithsej 72,848 studentë, ku 48,839 studentë ndjekin studimet në institucionet publike, ndërsa 29,009 studentë në institucionet private. Sa i përket strukturës institucionale, sektori publik përbëhet nga 7 universitete, 1 kolegji, 1 fakultet dhe 1 akademi, ndërsa në sektorin privat funksionojnë kryesisht 9 kolegje dhe 2 akademi. Këto të dhëna ofrojnë një pasqyrë të përgjithshme të shpërndarjes së




Figura 1. Institucionet e arsimit të lartë në Kosovë

institucioneve dhe studentëve në sistemin e arsimit të lartë në Kosovë dhe shërbejnë si bazë për analizën e mëtejshme të proceseve të akreditimit dhe zhvillimeve në sigurimin e cilësisë.

Gjatë vitit 2025, AKA ka pranuar gjithsej 178 aplikacione të paraqitura nga institucionet e arsimit të lartë për procese që ndërlidhen me akreditimin institucional, akreditimin e programeve të studimit, riakreditimin dhe validimin e programeve studimore.

Pas verifikimit administrativ të aplikacioneve nga AKA dhe shqyrtimit fillestar të tyre nga KShC, në përputhje me Ligjin Nr. 08/L-110 për AKA-në dhe Manualin e Akreditimit, gjithsej 143 aplikacione janë proceduar për vlerësim të mëtejshëm nga ekspertët ndërkombëtarë të angazhuar nga AKA, ndërsa pjesa tjetër janë refuzuar për shkak të mos plotësisë të kriterëve të përcaktuara me Manualin e Akreditimit.


Në bazë të raporteve të ekspertëve ndërkombëtarë dhe në përputhje me procedurat e përcaktuara në kuadrin ligjor dhe rregullativ të AKA-së, KShC ka shqyrtuar rekomandimet dhe ka marrë vendime përkatëse lidhur me akreditimin. Nga aplikacionet e vlerësuara, 9 kanë qenë për akreditim institucional, ndërsa 134 për akreditim të programeve të studimit.



Figura 2. Aplikacione të paraqitura në AKA; Në proces të vlerësimit janë përfshirë vetëm aplikacionet e aprovuara nga KSHC.

4.1.1 Akreditim institucional

Për procesin e akreditimit institucional, gjatë vitit 2025 në AKA janë paraqitur gjithsej 9 aplikacione nga institucionet e arsimit të lartë. Pas verifikimit administrativ nga AKA, aplikacionet shqyrtohen nga KShC, i cili vendos për miratimin e tyre për vlerësim. Aplikacionet e miratuara më pas vlerësohen nga ekspertë ndërkombëtarë në përputhje me standardet dhe procedurat e AKA-së. Në bazë të raporteve të ekspertëve ndërkombëtarë dhe pas shqyrtimit nga KShC, janë marrë gjithsej 8 vendime për akreditim institucional, ndërsa 1 vendim për mosakreditim.



Rezultatet tregojnë se shumica e institucioneve të vlerësuara kanë përmbushur standardet e përcaktuara për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë, ndërsa rastet e mosakreditimit lidhen me mospërmbushjen e kritereve të kërkuara sipas standardeve të akreditimit.

Figura 3. Akreditim institucional

4.1.2. Akreditim në nivel të programeve të studimit

Për akreditimin e programeve të studimit janë paraqitur gjithsej 134 aplikacione nga institucionet e arsimit të lartë. Pas verifikimit administrativ nga AKA dhe miratimit për procedurë të mëtejshme nga KShC, aplikacionet janë dërguar për vlerësim nga ekspertët ndërkombëtarë, në përputhje me standardet dhe procedurat e përcaktuara në kuadrin ligjor dhe rregullativ të AKA-së.

Nga numri i përgjithshëm i aplikacioneve të paraqitura, 75 aplikacione i përkasin programeve në nivel bachelor, 57 aplikacione në nivel master, dhe 2 aplikacione për programe të studimeve të doktoratës (PhD).

Në bazë të raporteve të ekspertëve ndërkombëtarë dhe pas shqyrtimit nga KShC, janë marrë gjithsej 125 vendime për akreditim dhe 9 vendime për mosakreditim të programeve të studimit.

Rezultatet e këtij procesi tregojnë se shumica e programeve të studimit të paraqitura për akreditim kanë përmbushur standardet e përcaktuara për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë, ndërsa rastet e mosakreditimit lidhen me mospërmbushjen e kriterëve dhe standardeve të përcaktuara në Manualin e Akreditimit të AKA-së.



Figura 4. Akreditim i programeve të studimit

4.2 Monitorimi

Monitorimi është pjesë e procesit të sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë dhe ka për qëllim verifikimin e vazhdueshëm të përmbushjes së kushteve të akreditimit nga institucionet e arsimit të lartë. Ky proces realizohet nga Divizioni për Monitorim në kuadër të AKA, në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullativ në fuqi.

Procesi i monitorimit zhvillohet në bazë të Manualit për Metodologjinë e Monitorimit dhe Procedurat Pas-akredituese, si dhe të Rregullores për Monitorim, të miratuara nga KShC. Këto dokumente përcaktojnë standardet, procedurat dhe mekanizmat për monitorimin e zbatimit të vendimeve të akreditimit nga institucionet e arsimit të lartë.

Gjatë vitit 2025, Divizioni për Monitorim ka realizuar vizita monitorimi në institucionet e arsimit të lartë publike dhe private, me qëllim verifikimin e zbatimit të kushteve të akreditimit dhe të standardeve të sigurimit të cilësisë në zhvillimin e programeve të studimit.

Në total janë realizuar 13 vizita monitorimi, në kuadër të të cilave janë monitoruar:

- 5 universitete publike, dhe
- 8 kolegje private.

Në kuadër të këtyre vizitave janë monitoruar gjithsej 60 programe studimi, prej të cilave:

- 52 programe në nivel Bachelor, dhe
- 8 programe në nivel Master.

Monitorimi është fokusuar kryesisht në verifikimin e bartësve të programeve të studimit, orareve të ligjëratave dhe ushtrimeve, publikimit të orareve në faqet zyrtare të institucioneve, si dhe në përputhshmërinë e zhvillimit të programeve të studimit me vendimet e akreditimit dhe dokumentacionin përkatës të programeve (shih Fig. 5).




Figura 5. Monitorimi i institucioneve dhe programeve të studimit

4.3 Procedurat Pas-akredituese

Procesi i Procedurave Pas-akredituese ka për qëllim vlerësimin e shkallës së zbatimit të rekomandimeve të përcaktuara në raportet e akreditimit fillestar dhe të riakreditimit, si dhe verifikimin e përmirësimeve të ndërmarra nga institucionet e arsimit të lartë. Ky proces realizohet përmes analizës së planeve për zbatimin e rekomandimeve, vizitave verifikuese dhe përgatitjes së raporteve përkatëse të vlerësimit, të cilat më pas i përcillen Këshillit Shtetëror të Cilësisë (KShC) për shqyrtim dhe vendimmarrje.

Në kuadër të procedurave pas-akredituese gjatë vitit 2025, AKA ka pranuar dhe analizuar Planet e Zbatimit të Rekomandimeve (PZR) të dorëzuara nga institucionet e arsimit të lartë. Këto plane paraqesin zotimet e institucioneve për adresimin e rekomandimeve të ekspertëve ndërkombëtarë dhe për përmirësimin e proceseve akademike dhe institucionale pas përfundimit të procesit të akreditimit. Gjatë këtij procesi janë pranuar, trajtuar dhe arkivuar gjithsej 120 PZR për programe studimi, si dhe 7 PZR në kuadër të akreditimit institucional. Analiza e këtyre planeve ka shërbyer si bazë për monitorimin e progresit të institucioneve në zbatimin e rekomandimeve dhe për identifikimin e masave konkrete të ndërmarra për ngritjen e cilësisë së programeve të studimit dhe të funksionimit institucional.

Në kuadër të procedurave pas-akredituese janë realizuar gjithsej 18 procese vlerësimi për programe studimi në institucione të ndryshme të arsimit të lartë, të cilat kanë përfshirë vizita verifikuese dhe hartimin e raporteve të vlerësimit nga ekspertë ndërkombëtarë.

Nga këto raporte, 12 i përkasin programeve në nivel bachelor, ndërsa 6 programeve në nivel master. Raportet vlerësojnë progresin e institucioneve në zbatimin e rekomandimeve të ekspertëve, analizën e dokumentacionit të dorëzuar nga institucionet dhe verifikimin e përmbushjes së standardeve të përcaktuara në procesin e akreditimit. Përzgjedhja e institucioneve dhe programeve të studimit për këtë proces është bërë në bazë të kërkesës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, duke reflektuar gjithashtu prioritetet e AKA-së për zbatimin e politikave të procedurave pas-akredituese.

Përzgjedhja është bazuar në një matricë të vlerësimit të riskut, duke marrë në konsideratë nivelin e përputhshmërisë me standardet e akreditimit, numrin dhe natyrën e rekomandimeve të dhëna gjatë procesit të akreditimit, si dhe nevojën për verifikim të progresit të institucioneve në adresimin e tyre.

Procedura pas-akredituese




Figura 6. Procedura pas-akredituese

5. Komisioni i Ankesave (KA)

5.1. Baza ligjore e funksionimit

Komisioni i Ankesave (KA) i AKA-së ka kryer detyrat dhe përgjegjësitë sipas autorizimeve ligjore bazuar në Rregulloren AKA Nr.01/2024 për punën e Komisionit të Ankesave e cila ka hyrë në fuqi dhe është zbatuar nga data 15.01.2024. Tutje kjo rregullore derivon nga Ligji Nr. 08/L-110 për AKA-në, i cili është miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës me datë 29.06.2023, ligj i cili specifikon autorizimet, struktura, mënyra e vendimmarrjes dhe aspekte tjera relevante për KA.

5.2. Përmbledhje

Raporti i KA synon të ofrojë një pasqyrë të qartë mbi mbledhjet e mbajtura, vendimet e nxjerra, seancat dëgjimore të zhvilluara, si dhe mbi angazhimin e Komisionit në garantimin e një shqyrtimi të rregullt, të paanshëm dhe ligjërisht të bazuar të ankesave të paraqitura nga institucionet e arsimit të lartë.

Komisioni i Ankesave, si organ përgjegjës për shqyrtimin administrativ të ankesave në kuadër të sistemit të akreditimit, ka ushtruar gjatë vitit 2025 kompetencat e tij në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me aktet nënligjore përkatëse.

Komisioni ka kontribuar në forcimin e parimeve të ligjshmërisë, transparencës, objektivitetit dhe të drejtës së palëve për shqyrtim të drejtë administrativ. Ky raport përmbledh të dhënat kryesore të punës së realizuar gjatë periudhës raportuese dhe shërben si dokument informues për institucionet përkatëse shtetërore.

5.3. Përbërja e Komisionit të Ankesave

- Prof. dr. Ibish Mazreku, Kryetar;
- Prof. Asoc. Dr. Fatos Rexhepi, Anëtar;
- Jurist Lirik Veselaj, Anëtar;
- Jurist Nexhat Kelmendi, Anëtar.

5.4. Aktiviteti i Komisionit të Ankesave gjatë vitit 2025

Gjatë vitit 2025, Komisioni i Ankesave ka zhvilluar aktivitetet të rregullt dhe të vazhdueshëm në trajtimin e ankesave të paraqitura. Aktiviteti është materializuar përmes mbledhjeve të punës, shqyrtimit të dokumentacionit administrativ, mbajtjes së seancave dëgjimore dhe nxjerrjes së vendimeve lidhur me ankesat e paraqitura.

Numri dhe shpërndarja e aktiviteteve gjatë muajve të vitit pasqyrojnë intensitetin e punës së Komisionit dhe nevojën për trajtim sistematik të çështjeve që ndërlidhen me proceset e akreditimit dhe sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë.

Tabela 1. Përmbledhje statistikore e veprimtarisë së Komisionit gjatë vitit 2025




Tabela 1. Përmbledhje statistikore e veprimtarisë së Komisionit për vitin 2025

Treguesi	Numri	Vërejtje
Mbledhje të mbajtura	21	Aktivitet i shpërndarë përgjatë gjithë vitit
Vendime të nxjerra	24	Përfshin aprovime dhe refuzime
Seanca dëgjimore	23	Në pajtim me LPPA dhe të drejtën e palëve për t'u dëgjuar
Ankesa të aprovuara	14	Të vlerësuara si të bazuara
Ankesa të refuzuara	10	Të vlerësuara si të pabazuara

5.5. Mbledhjet e Komisionit të Ankesave

Gjatë periudhës raportuese, Komisioni i Ankesave ka mbajtur gjithsej 21 mbledhje. Këto mbledhje kanë shërbyer për shqyrtimin e lëndëve, organizimin e seancave dëgjimore, analizën e dokumentacionit dhe vendimmarrjen lidhur me ankesat e paraqitura.

Shpërndarja mujore e mbledhjeve dëshmon një ritëm të qëndrueshëm pune dhe një përkushtim institucional në përmbushjen e mandatit të Komisionit.




Figura 7. Mbledhjet e Komisionit të Ankesave sipas muajve

5.6. Vendimmarrja e Komisionit të Ankesave

Gjatë vitit 2025, Komisioni i Ankesave ka nxjerrë gjithsej 24 vendime lidhur me ankesat e paraqitura nga institucionet e arsimit të lartë. Vendimmarrja është zhvilluar mbi bazën e shqyrtimit të dokumentacionit përkatës, zhvillimit të procedurave dëgjimore dhe vlerësimit juridik e faktik të secilit rast.

Nga numri i përgjithshëm i vendimeve, 14 ankesa janë aprovuar si të bazuara, ndërsa 10 ankesa janë refuzuar si të pabazuara. Kjo strukturë tregon se Komisioni ka ushtruar funksionin e tij në mënyrë të balancuar, duke trajtuar secilin rast në mënyrë individuale dhe të arsyetuar.

5.7. Seancat dëgjimore

Në zbatim të nenit 95 paragrafi (1) të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Komisioni i Ankesave ka mbajtur gjithsej 23 seanca dëgjimore gjatë periudhës raportuese.

Mbajtja e këtyre seancave ka qenë me rëndësi të veçantë për respektimin e së drejtës së palëve për t'u dëgjuar, për sqarimin e rrethanave faktike dhe për garantimin e një procedure administrative të drejtë, transparente dhe gjithëpërfshirëse.




Figura 8. Numri i seancave dëgjimore

5.8. Vlerësim i përgjithshëm i punës së Komisionit

Nga të dhënat e paraqitura rezulton se Komisioni i Ankesave ka zhvilluar një aktivitet të rregullt, intensiv dhe funksional gjatë vitit 2025. Numri i mbledhjeve, i vendimeve dhe i seancave dëgjimore tregon për një angazhim të vazhdueshëm institucional në ushtrimin e mandatit të tij.

Puna e Komisionit gjatë kësaj periudhe është karakterizuar nga trajtimi i rregullt i ankesave, zhvillimi i procedurave dëgjimore në pajtim me legjislacionin në fuqi, si dhe vendimmarrja administrative mbi bazën e shqyrtimit të secilës lëndë. Kjo veprimtari ka kontribuar në ruajtjen e standardeve të ligjshmërisë, transparencës dhe llogaridhënies në proceset e akreditimit.

6. Zhvillimet institucionale dhe aktivitetet kryesore të Agjencisë

6.1. Njohja ndërkombëtare e AKA-së dhe arritjet strategjike

Gjatë periudhës raportuese, AKA ka shënuar zhvillime të rëndësishme në drejtim të forcimit të pozicionit të saj në rrjetet ndërkombëtare të sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë. Këto zhvillime përfshijnë avancimin e bashkëpunimit me organizata dhe agjenci ndërkombëtare, si dhe rritjen e përputhshmërisë së proceseve të AKA-së me standardet dhe praktiket evropiane të sigurimit të cilësisë. Në këtë kuadër, AKA ka vazhduar të kontribuojë në shkëmbimin e përvojave dhe në promovimin e praktikave të zhvilluara në Kosovë në forume dhe rrjete ndërkombëtare të sigurimit të cilësisë.

6.1.1. Regjistrimi i AKA-së në Regjistrin Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (EQAR)

Agjencia e Kosovës për Akreditim u regjistrua në Regjistrin Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (EQAR), pas një procesi vlerësimi të pavarur ndërkombëtar të realizuar në përputhje me Standardet dhe Udhëzimet Evropiane për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ESG). Vlerësimi i përshtatshmërisë së AKA-së me ESG standardet është bërë nga një panel i Asociacionit Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA) prej pesë anëtarësh. Bazuar në

raportin pozitiv të ekspertëve të ENQA, AKA është regjistruar në EQAR. Kosova është vendi i vetëm në Ballkanin Perëndimor që është regjistruar në EQAR ²⁹.

Regjistrimi në EQAR konfirmon përputhshmërinë e proceseve dhe procedurave të AKA-së me standardet evropiane për sigurimin e cilësisë. Ky zhvillim përfaqëson një hap të rëndësishëm në forcimin e kredibilitetit ndërkombëtar të sistemit të sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë në Republikën e Kosovës dhe kontribuon në rritjen e besueshmërisë së proceseve të akreditimit dhe vlerësimit institucional. Regjistrimi në EQAR mundëson gjithashtu zgjerimin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe integrimin më të thellë të sistemit të arsimit të lartë të Kosovës në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë (EHEA), duke mbështetur zhvillimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në institucionet e arsimit të lartë.




Figura 9. Ueb faqja zyrtare e EQAR ku listohet shteti i Kosovës dhe AKA

AKA tashmë ka ngarkuar në databazën e EQAR-it, të quajtur DEQAR, vendimet për akreditimin e programeve të studimit në Kosovë ³⁰. DEQAR është databaza evropiane e rezultateve të sigurimit të jashtëm të cilësisë në arsimin e lartë, ku publikohen raportet dhe vendimet e vlerësimeve të jashtme të kryera nga agjenci të regjistruara në EQAR. Në këtë mënyrë, informacioni për programet e

²⁹ <https://www.eqar.eu/register/agencies/>

³⁰ <https://www.eqar.eu/register/agencies/agency/?id=33>

studimit në Kosovë bëhet më i qasshëm, më transparent dhe më lehtë i verifikueshëm nga institucionet, studentët dhe palët tjera të interesit brenda dhe jashtë vendit.

Roli i DEQAR-it është që të shërbejë si një pikë e përbashkët reference për rezultatet e akreditimit dhe vlerësimit të jashtëm të cilësisë. Përmes kësaj databaze, vendimet e AKA-së nuk mbesin vetëm në nivel kombëtar, por bëhen pjesë e një sistemi më të gjerë evropian të transparencës dhe besueshmërisë në arsimin e lartë. Kjo ndihmon që programet e studimit të Kosovës të jenë më të dukshme dhe më të kuptueshme për partnerët ndërkombëtarë.

Përfshirja e vendimeve në DEQAR ka rëndësi të veçantë edhe për njohjen dhe krahasueshmërinë ndërkombëtare. Kur një program studimi figuron në këtë databazë, bëhet më e lehtë për institucione, autoritete dhe organizata të huaja të verifikojnë se ai ka kaluar një proces të jashtëm të sigurimit të cilësisë nga një agjenci e regjistruar në EQAR. Kjo forcon besimin në sistemin e arsimit të lartë të Kosovës dhe kontribuon në rritjen e reputacionit të AKA-së në nivel evropian.



The screenshot shows the EQAR website interface. The top navigation bar includes 'Register', 'Database', 'Knowledge base', 'News', and 'About'. The main content area displays the profile for 'KAA - Kosovo Accreditation Agency'. The breadcrumb trail is 'eqar.eu > Register > Registered agencies > KAA'. The agency name is 'KAA - Kosovo Accreditation Agency' with the Albanian name 'Agjencia e Kosoves per Akreditim' below it. A blue badge indicates 'SUBSTANTIAL COMPLIANCE WITH THE ESG'. An orange button says 'VIEW 76 REPORTS ON 17 INSTITUTIONS'. A table lists registration details:

Registration valid until	31/12/2029 (listed since 01/12/2024)
Registration note	The agency was previously registered on EQAR between 2015-06-05 and 2017-09-25
Website	https://akreditimi.rks-gov.net/accreditation-standards/

6.1.2. Takimi me përfaqësues të CHEA-së për mundësinë e anëtarësimit të AKA-së

Në kuadër të konferencës ndërkombëtare të Këshillit për Akreditimin e Arsimit të Lartë të Shteteve të Bashkuara (CHEA), të mbajtur në Uashington, Drejtori i Përgjithshëm i AKA-së ka zhvilluar një takim me zëvendëspresidenten për kërkime dhe analizë të politikave në CHEA. Gjatë këtij takimi është diskutuar mundësia e anëtarësimit të AKA-së në këtë organizatë, fillimisht në cilësinë e

anëtarit, si dhe nisja e procesit për plotësimin e kriterëve që do të mundësonin njohjen e akreditimeve të institucioneve të arsimit të lartë të Kosovës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. CHEA është një organizatë në nivel federal në Shtetet e Bashkuara që merret me njohjen e agjencive akredituese të arsimit të lartë dhe konsiderohet homologe e Asociacionit Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA) në Evropë. Njohja e AKA-së nga CHEA do të kontribuonte në rritjen e ndërkombëtarizimit dhe besueshmërisë së sistemit të arsimit të lartë në Republikën e Kosovës, duke ndikuar në njohjen më të gjerë të diplomave të institucioneve të arsimit të lartë të Kosovës në Shtetet e Bashkuara, si për vazhdimin e studimeve ashtu edhe për mundësitë e punësimit.

6.1.3. Vlerësimi i Komisionit Evropian për sistemin e sigurimit të cilësisë në Kosovë

Në Raportin për Kosovën të vitit 2025, Komisioni Evropian vlerësoi AKA-në për përparimin dhe përputhshmërinë e saj me standardet evropiane të sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë. Raporti vlerëson gjithashtu zhvillimin e kapaciteteve institucionale të Agjencisë, përfshirë zgjerimin e stafit profesional, përmirësimin e proceseve të brendshme të sigurimit të cilësisë dhe përfshirjen e studentëve dhe përfaqësuesve të industrisë në proceset vendimmarrëse.

Ky vlerësim reflekton përparimin e bërë në zhvillimin e sistemit të sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë dhe konfirmon përafrimin e proceseve të Agjencisë me standardet dhe praktikat evropiane në këtë fushë.

6.1.4. Publikimi i analizës tematike

Agjencia e Kosovës për Akreditim publikoi analizën tematike “Enhancing Scientific Research through External Quality Assurance (EQA) Mechanisms”, e cila shqyrton ndikimin e mekanizmeve të sigurimit të jashtëm të cilësisë në zhvillimin e kërkimit shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Kosovë. Studimi bazohet në analizën e mbi 60 raporteve të akreditimit dhe riakreditimit për periudhën 2019–2024, si dhe në të dhëna të mbledhura përmes një ankete të realizuar me institucionet e arsimit të lartë. Analiza trajton mënyrën se si standardet e vlerësimit të kërkimit shkencor ndikojnë në strategjitë institucionale, produktivitetin e stafit akademik, përfshirjen e studentëve në kërkim dhe në zhvillimin e mekanizmeve institucionale për mbështetjen e kërkimit shkencor. Gjetjet e analizës tregojnë se proceset e vlerësimit të jashtëm nga AKA kanë kontribuar

në rritjen e fokusit institucional në kërkimin shkencor, përmirësimin e politikave dhe strategjive për publikime shkencore dhe forcimin e mekanizmave të brendshëm të sigurimit të cilësisë në këtë fushë. Në të njëjtën kohë, analiza identifikon sfida që lidhen me financimin e kërkimit, kapacitetet infrastrukture dhe mbështetjen institucionale për aktivitetet kërkimore. Ky publikim përbën një kontribut të rëndësishëm analitik për zhvillimin e mëtejshëm të politikave dhe mekanizmave të sigurimit të cilësisë që lidhen me kërkimin shkencor në arsimin e lartë në Kosovë.

6.2. Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe përfaqësimi i AKA-së në rrjetet dhe forumet e sigurimit të cilësisë

Bashkëpunimi ndërkombëtar përbën një element të rëndësishëm në zhvillimin dhe avancimin e mekanizmave të sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë. Përmes pjesëmarrjes në rrjete, seminare dhe forume ndërkombëtare, Agjencia e Kosovës për Akreditim kontribuon në shkëmbimin e përvojave dhe në ndjekjen e praktikave më të mira evropiane dhe ndërkombëtare në këtë fushë. Këto aktivitete mbështesin gjithashtu përfaqësimin institucional të AKA-së dhe forcimin e bashkëpunimit me agjenci dhe organizata homologe në nivel ndërkombëtar.

6.2.1. Pjesëmarrja e AKA-së në seminarin e ENQA-së në Madrid

Përfaqësuesit e AKA-së morën pjesë në një seminar të organizuar nga Asociacioni Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA), ku prezantuan përvojën e AKA-së në procesin e vlerësimit të jashtëm dhe ndikimin e këtij procesi në përmirësimin e mekanizmave të sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë në Republikën e Kosovës. Seminari u organizua nga Agjencia Kombëtare për Vlerësimin dhe Akreditimin e Cilësisë në Spanjë (ANECA) dhe mbledhi përfaqësues të ENQA-së, Regjistrin Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (EQAR) dhe agjencive të sigurimit të cilësisë nga vende të ndryshme evropiane.

Gjatë prezantimit u theksua roli i procesit të vlerësimit nga ENQA në avancimin e proceseve të sigurimit të cilësisë në Kosovë, duke kontribuar në përmirësimin e procedurave të vlerësimit, rritjen e transparencës institucionale dhe forcimin e përputhshmërisë me Standardet dhe Udhëzimet Evropiane për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ESG).

Seminari ofroi gjithashtu një platformë për diskutimin e metodologjive të rishikimeve të jashtme të agjencive të sigurimit të cilësisë, përfshirë përgatitjen e raporteve të vetëvlerësimit dhe praktikave më të mira në proceset e vlerësimit. Pjesëmarrja e AKA-së në këtë aktivitet kontribuoi në shkëmbimin e përvojave dhe në forcimin e bashkëpunimit me agjencitë evropiane të sigurimit të cilësisë, duke mbështetur zhvillimin e mëtejshëm të mekanizmave të sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë në Republikën e Kosovës.

6.2.2. Prezantimi i përvojës së AKA-së në asamblenë e përgjithshme të ENQA-së në Qipro

Përfaqësues të AKA-së morën pjesë në Asamblenë e Përgjithshme të Asociacionit Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA), të mbajtur në Paphos, Qipro, ku prezantuan publikimin mbi rolin e procesit të vlerësimit nga ENQA në zhvillimin institucional të AKA-së. Gjatë prezantimit u paraqitën zhvillimet dhe reformat e realizuara nga AKA pas vlerësimit të mëparshëm nga ENQA, duke përfshirë përmirësimin e kuadrit ligjor, forcimin e kapaciteteve institucionale dhe rritjen e përputhshmërisë me Standardet dhe Udhëzimet Evropiane për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ESG). Po ashtu u theksua se procesi i vlerësimit nga ENQA ka kontribuar në avancimin e procedurave të sigurimit të cilësisë dhe në forcimin e transparencës dhe besueshmërisë institucionale. Në këtë aktivitet u diskutua edhe rëndësia e reformave institucionale të ndërmarra në Kosovë, përfshirë miratimin e ligjit për AKA-në dhe zhvillimin e kapaciteteve profesionale dhe infrastrukture të agjencisë, të cilat kanë mbështetur përmirësimin e mekanizmave të sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë. Pjesëmarrja në këtë forum ndërkombëtar mundësoi prezantimin e përvojës së Kosovës dhe diskutimin e zhvillimeve aktuale në sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë me agjencitë homologe evropiane.

6.2.3. Prezantimi i praktikave të AKA-së për procedurat pas-akredituese në rrjetin CEENQA

Agjencia e Kosovës për Akreditim ka prezantuar përvojën e saj në zbatimin e procedurave pas-akredituese në takimin e rregullt të Rrjetit të Agjencive të Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë të Evropës Qendrore dhe Lindore (CEENQA). Gjatë këtij aktiviteti janë prezantuar praktikave dhe metodologjia e AKA-së për zbatimin e procedurave pas-akredituese, të cilat synojnë të sigurojnë që institucionet e arsimit të lartë të ruajnë dhe të përmirësojnë standardet e cilësisë gjatë periudhës së vlefshmërisë së akreditimit. Këto procedura përfshijnë verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të

dhëna nga ekspertët ndërkombëtarë gjatë procesit të akreditimit dhe monitorimin e progresit të institucioneve në përmirësimin e programeve të studimit. Në kuadër të këtij procesi, institucionet e arsimit të lartë janë të obliguara të paraqesin në AKA planin e zbatimit të rekomandimeve të marra gjatë procesit të akreditimit. Prezantimi i këtyre praktikave mundësoi ndarjen e përvojës së AKA-së me agjencitë e rajonit dhe diskutimin e qasjeve të ndryshme për zbatimin e procedurave pas-akredituese në sistemet e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë.

6.2.4. Prezantimi i përvojës së AKA-së në takimin e RCC-së në Kroaci

Përfaqësues të AKA-së morën pjesë në takimin e organizuar në kuadër të Këshillit Rajonal për Bashkëpunim (Regional Cooperation Council – RCC), i cili u mbajt në Zagreb të Kroacisë, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të agjencive të sigurimit të cilësisë nga vendet e Ballkanit Perëndimor. Gjatë këtij aktiviteti u prezantua përvoja e Kosovës në procesin e vlerësimit nga Asociacioni Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA) dhe ndikimi i këtij procesi në zhvillimin institucional të AKA-së. Në prezantim u theksuan përmirësimet e realizuara në kuadrin ligjor dhe rregullativ, zhvillimi i kapaciteteve institucionale dhe avancimi i procedurave të sigurimit të cilësisë në përputhje me Standardet dhe Udhëzimet Evropiane për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ESG). Takimi në kuadër të Këshillit Rajonal për Bashkëpunim shërbeu gjithashtu si një platformë për shkëmbimin e përvojave ndërmjet agjencive të sigurimit të cilësisë të rajonit, me fokus në sfidat dhe praktikat më të mira në zbatimin e standardeve ESG dhe në përgatitjen për proceset e vlerësimit të jashtëm nga ENQA. Diskutimet e zhvilluara në këtë takim kontribuan në thellimin e bashkëpunimit rajonal dhe në ndarjen e përvojave mbi zhvillimin e sistemeve të sigurimit të cilësisë në vendet e Ballkanit Perëndimor.

6.2.5. Shkëmbimi i përvojave me Kroacinë për programet e përbashkëta dhe të dyfishta të studimit

Përfaqësues të AKA-së zhvilluan një vizitë pune në Universitetin e Zagrebit, ku u diskutuan përvojat e Kroacisë në zhvillimin dhe zbatimin e programeve të përbashkëta dhe të dyfishta të studimit në arsimin e lartë. Gjatë diskutimeve u prezantuan praktikat e institucioneve kroate në hartimin dhe implementimin e këtyre programeve, si dhe përvojat e tyre në sigurimin e qëndrueshmërisë dhe cilësisë së bashkëpunimeve akademike ndërkombëtare. Këto përvoja janë të rëndësishme për

procesin e zhvillimit të kornizës rregullative në Kosovë që do të mundësojë ofrimin e programeve të përbashkëta dhe të dyfishta të studimit nga institucionet e arsimit të lartë në bashkëpunim me partnerë ndërkombëtarë. Në kuadër të vizitës u zhvilluan gjithashtu takime me ekspertë dhe përfaqësues të institucioneve kroate të sigurimit të cilësisë, gjatë të cilave u shkëmbyen përvoja mbi praktikat më të mira në zbatimin e Standardeve dhe Udhëzimeve Evropiane për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ESG). Ky aktivitet shërbeu si një mundësi për thellimin e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe për diskutimin e zhvillimit të politikave që mbështesin ndërkombëtarizimin dhe cilësinë e programeve të studimit në arsimin e lartë në Kosovë.

6.2.6. Vizitë institucionale e AKA-së në Universitetin Rikkyo në Japoni

Në kuadër të pjesëmarrjes në aktivitetet e Rrjetit Ndërkombëtar të Agjencive për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (INQAAHE) në Tokio të Japonisë, delegacioni i AKA-së realizoi një vizitë institucionale në Universitetin Rikkyo, ku u diskutuan mundësitë për shkëmbimin e përvojave dhe praktikave më të mira në fushën e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë. Gjatë këtij takimi u shqyrtuan mundësitë për bashkëpunim akademik dhe përfshirjen e ekspertëve ndërkombëtarë në proceset e vlerësimit të programeve të studimit në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Kosovës. Diskutimet u fokusuan në rëndësinë e bashkëpunimit ndërkombëtar për zhvillimin e mekanizmave të sigurimit të cilësisë dhe për avancimin e standardeve akademike. Në kuadër të kësaj vizite, delegacioni i AKA-së zhvilloi gjithashtu një takim në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Japoni, ku u diskutua për rëndësinë e pjesëmarrjes së institucioneve të Kosovës në forume dhe rrjete ndërkombëtare që lidhen me sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë. Këto aktivitete kontribuojnë në forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe në promovimin e shkëmbimit të përvojave me institucione dhe ekspertë ndërkombëtarë, duke mbështetur zhvillimin e mëtejshëm të mekanizmave të sigurimit të cilësisë dhe ndërkombëtarizimin e arsimit të lartë në Republikën e Kosovës.

6.2.7. Konferenca Vjetore e ATMAE-së në Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Përfaqësues të AKA-së morën pjesë në Konferencën Vjetore të Asociacionit për Teknologji, Menaxhment dhe Inxhinieri të Aplikuar (ATMAE), e mbajtur në Memphis, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Konferenca mbledhi përfaqësues të institucioneve dhe organizatave që veprojnë në

fushën e sigurimit të cilësisë dhe akreditimit në arsimin e lartë. Në kuadër të këtij aktiviteti u zhvilluan diskutime dhe shkëmbime përvojash me përfaqësues të organizatave amerikane të akreditimit lidhur me zhvillimin e standardeve dhe praktikave të sigurimit të cilësisë në programet akademike në fushën e teknologjisë, menaxhmentit dhe inxhinierisë së aplikuar. Përvojat dhe praktikave të prezantuara në këtë konferencë kontribuan në thellimin e njohurive mbi zhvillimet aktuale në sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë dhe në forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e akreditimit. Gjithashtu, këto diskutime mbështetën proceset e ndërkombëtarizimit të AKA-së dhe përpjekjet për zgjerimin e bashkëpunimit me organizata ndërkombëtare, përfshirë Këshillin për Akreditimin e Arsimit të Lartë në Shtetet e Bashkuara (CHEA).

6.2.8. Bashkëpunimi me Ambasadën e SHBA-së në mbështetje të zhvillimit të sigurimit të cilësisë

Përfaqësuesit e AKA-së zhvilluan një takim me përfaqësues të Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Prishtinë, në të cilin u diskutua vazhdimi i bashkëpunimit në mbështetje të zhvillimit të sistemit të sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë në Republikën e Kosovës.

Gjatë këtij takimi u trajtua bashkëpunimi i deritanishëm ndërmjet AKA-së dhe Ambasadës së SHBA-së, veçanërisht në projektet që kanë kontribuar në zhvillimin e kapaciteteve institucionale dhe teknike të Agjencisë, si dhe në avancimin e proceseve të akreditimit dhe sigurimit të cilësisë.

Në kuadër të diskutimeve u theksua gjithashtu rëndësia e vazhimit të mbështetjes në projekte që kontribuojnë në ndërkombëtarizimin e sistemit të arsimit të lartë në Kosovë dhe në forcimin e bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë në fushën e sigurimit të cilësisë.

6.2.9. Bashkëpunimi me Maqedoninë e Veriut në fushën e sigurimit të cilësisë

Agjencia e Kosovës për Akreditim priti një delegacion nga Agjencia për Cilësi në Arsimin e Lartë e Maqedonisë së Veriut, me qëllim shkëmbimin e përvojave dhe forcimin e bashkëpunimit rajonal në zbatimin e Standardeve dhe Udhëzimeve Evropiane për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ESG). Gjatë takimit u prezantua zhvillimi institucional i AKA-së, duke përfshirë përmirësimin e kuadrit ligjor dhe rregullativ, zhvillimin e kapaciteteve institucionale dhe avancimin e proceseve të sigurimit të cilësisë në përputhje me standardet ESG dhe rekomandimet e Asociacionit Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA). Takimi shërbeu gjithashtu për shkëmbimin e përvojave mbi organizimin e proceseve të akreditimit, monitorimit dhe procedurave pas-akredituese,

si dhe për diskutimin e praktikave të përdorura nga të dy agjencitë në forcimin e mekanizmave të sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë. Ky aktivitet kontribuoi në forcimin e bashkëpunimit rajonal dhe në shkëmbimin e praktikave më të mira ndërmjet agjencive homologe, me qëllim avancimin e standardeve të sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë.

6.2.10. Pjesëmarrja në punëtorinë e ENQA-së për inteligjencën artificiale në Estoni

Përfaqësues të AKA-së morën pjesë në një punëtori të organizuar nga Asociacioni Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA), e cila u mbajt në Tallinn të Estonisë dhe u fokusua në përdorimin e inteligjencës artificiale në proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë. Punëtorja trajtoi përdorimin e përgjegjshëm dhe etik të inteligjencës artificiale në aktivitetet e agjencive të sigurimit të cilësisë, duke diskutuar mundësitë dhe sfidat që kjo teknologji sjell në proceset e vlerësimit, akreditimit dhe vendimmarrjes institucionale.

Gjatë këtij aktiviteti, përfaqësues të agjencive të sigurimit të cilësisë nga vende të ndryshme evropiane prezantuan praktika dhe përvoja mbi përdorimin e teknologjive të reja në proceset e vlerësimit dhe monitorimit të institucioneve të arsimit të lartë. Pjesëmarrja e AKA-së në këtë aktivitet kontribuoi në shkëmbimin e përvojave me agjencitë evropiane të sigurimit të cilësisë dhe në identifikimin e qasjeve inovative që mund të mbështesin përmirësimin e proceseve të akreditimit në përputhje me standardet evropiane.

6.2.11. Pjesëmarrja në seminarin e ENQA-së për sigurimin e cilësisë në Belgjikë

Seminari i organizuar nga Asociacioni Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA) me temë “Dimensioni Evropian i Sigurimit të Cilësisë” u mbajt në Bruksel, Belgjikë. Seminari trajtoi zhvillimet më të fundit në politikat dhe praktikat evropiane të sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë, duke përfshirë procesin e Bolonjës, prioritetet e Komisionit Evropian në fushën e arsimit të lartë, rolin e organizatave në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë dhe procesin e rishikimit të Standardeve dhe Udhëzuesve Evropianë për Sigurimin e Cilësisë (ESG). Diskutimet dhe shkëmbimi i përvojave ndërmjet agjencive dhe institucioneve evropiane të sigurimit të cilësisë kontribuojnë në zhvillimin profesional të stafit dhe në përafrimin e mëtejshëm të proceseve të AKA-së me praktikat dhe standardet evropiane të sigurimit të cilësisë.

6.2.12. Forumi Evropian për Sigurimin e Cilësisë (EQAF) 2025 në Budapest, Hungari

Agjencia e Kosovës për Akreditim u përfaqësua në Forumin Evropian për Sigurimin e Cilësisë (European Quality Assurance Forum – EQAF) 2025, të mbajtur në Universitetin Corvinus të Budapestit, Hungari. Forumi, i organizuar nga ENQA, EUA, ESU dhe EURASHE, përbën një nga ngjarjet kryesore evropiane në fushën e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë. Diskutimet në kuadër të forumit u fokusuan në zhvillimet aktuale në sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë, me theks në rolin e institucioneve të sigurimit të cilësisë në ruajtjen e stabilitetit institucional, autonomisë akademike dhe bashkëpunimit ndërkombëtar. Pjesëmarrja në këtë forum mundësoi shkëmbimin e përvojave dhe praktikave të mira me agjenci dhe institucione evropiane të sigurimit të cilësisë, si dhe kontribuoi në përafrimin e mëtejshëm të proceseve të AKA-së me standardet dhe zhvillimet evropiane në këtë fushë.

6.2.13. Konferenca ndërkombëtare për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë në Kroaci

Delegacioni i AKA-së mori pjesë në aktivitetet e organizuara në Zagreb, Kroaci, me rastin e 20-vjetorit të themelimit të Agjencisë për Shkencë dhe Arsim të Lartë të Kroacisë (ASHE). Në kuadër të kësaj vizite u zhvilluan takime me përfaqësues të ASHE, ku u diskutua për thellimin e bashkëpunimit ndërinstitucional, shkëmbimin e praktikave të mira dhe zhvillimin e mëtejshëm të proceseve të sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë. Gjatë aktivitetëve u organizua edhe konferenca ndërkombëtare “Cilësia në Arsimin e Lartë dhe Shkencë: Nga sfidat te mundësitë së bashku”, ku u diskutuan zhvillimet dhe sfidat aktuale në fushën e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë. Në kuadër të këtij aktiviteti u diskutuan zhvillimet dhe sfidat aktuale në fushën e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë. Aktiviteti shërbeu gjithashtu për thellimin e bashkëpunimit me agjencitë homologe evropiane dhe për ndarjen e përvojave që lidhen me zhvillimin dhe përmirësimin e proceseve të sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë në Kosovë.

6.3. Bashkëpunimi me institucionet e arsimit të lartë dhe aktivitetet e AKA-së në Kosovë

Agjencia e Kosovës për Akreditim zhvillon në mënyrë të vazhdueshme aktivitete bashkëpunimi me institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Kosovës. Këto aktivitete përfshijnë takime informuese, trajnime, konferenca dhe vizita institucionale që synojnë rritjen e transparencës dhe

koordinimit institucional. Përmes këtyre angazhimeve, AKA kontribuon në zhvillimin e një kulture të qëndrueshme të sigurimit të cilësisë në sistemin e arsimit të lartë në Kosovë.

6.3.1. Mbledhja vjetore e AKA me drejtuesit e institucioneve të arsimit të lartë

Këshilli Shtetëror i Cilësisë dhe drejtuesit e AKA-së organizuan mbledhjen e rregullt vjetore me përfaqësuesit e institucioneve publike dhe private të arsimit të lartë në Republikën e Kosovës. Aktiviteti u zhvillua në dy seanca të ndara dhe kishte për qëllim diskutimin e çështjeve kryesore që lidhen me procesin e akreditimit, sigurimin e cilësisë dhe zhvillimet strategjike në arsimin e lartë. Në këtë aktivitet morën pjesë rektorë, dekanë dhe përfaqësues të zyrave për sigurimin e cilësisë nga institucionet e arsimit të lartë, të cilët u informuan për zhvillimet më të fundit në proceset e akreditimit dhe sigurimit të cilësisë. Gjithashtu u diskutua për rëndësinë e bashkëpunimit ndërinstitucional në përmirësimin e proceseve të vlerësimit dhe avancimin e standardeve të cilësisë në arsimin e lartë.

Gjatë diskutimeve u prezantuan zhvillimet e fundit në kuadër të AKA-së, përfshirë kompletimin e bazës ligjore dhe rregullative që derivon nga Ligji për AKA-në, si dhe inicimin e procesit për hartimin e Strategjisë së AKA-së për periudhën 2026–2031. Përfaqësuesit e institucioneve të arsimit të lartë u inkurajuan të kontribuojnë në procesin e hartimit të kësaj strategjie përmes përfshirjes në grupet punuese përkatëse. Diskutimet u fokusuan gjithashtu në përmirësimin e proceseve të akreditimit dhe sigurimit të cilësisë, zhvillimin profesional të stafit akademik, avancimin e metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, si dhe rritjen e ndërkombëtarizimit të institucioneve të arsimit të lartë. Ky aktivitet shërbeu si një platformë e rëndësishme për forcimin e bashkëpunimit ndërmjet AKA-së dhe institucioneve të arsimit të lartë, me qëllim të avancimit të vazhdueshëm të cilësisë në sistemin e arsimit të lartë në Republikën e Kosovës.

6.3.2. Konferenca vjetore ndërkombëtare e AKA-së për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë

Agjencia e Kosovës për Akreditim organizoi konferencën vjetore ndërkombëtare për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të agjencive evropiane të sigurimit të cilësisë, institucioneve të arsimit të lartë dhe ekspertëve ndërkombëtarë të fushës.

Paraprakisht, KShC kishte formuar Grupin Punues për përgatitjen e Konferencës së vjetore, në përbërje të të cilit ishin anëtarë të Bordit dhe stafi i AKA-së.

Konferenca shërbeu si platformë për diskutimin e zhvillimeve aktuale në sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë dhe për shkëmbimin e përvojave ndërkombëtare. Programi i konferencës përfshiu prezantime dhe diskutime mbi rolin e sigurimit të cilësisë në ndërtimin e besimit në arsimin e lartë evropian, përputhshmërinë me Standardet dhe Udhëzimet Evropiane për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ESG), si dhe zhvillimet e fundit në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë (EHEA). Në kuadër të konferencës u zhvilluan edhe sesione tematike mbi bashkëpunimin ndërkufitar në arsimin e lartë dhe ndikimin e proceseve ndërkombëtare në sistemet kombëtare të sigurimit të cilësisë. Konferenca kontribuoi në forcimin e dialogut profesional dhe në avancimin e bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë.

6.3.3. Vizitat informuese në institucionet e arsimit të lartë

Në kuadër të zbatimit të Planit të Punës për vitin akademik 2025/2026, Divizioni për Monitorim i AKA-së realizoi një seri vizitash informuese në institucionet publike dhe private të arsimit të lartë në Republikën e Kosovës. Vizitat u zhvilluan në përputhje me Rregulloren për Monitorim Nr. 04/2025 dhe kishin për qëllim informimin e institucioneve lidhur me procedurat dhe kërkesat e procesit të monitorimit. Gjatë këtij procesi u realizuan 21 vizita informuese, në të cilat u diskutuan çështje që lidhen me funksionimin e mekanizmave të brendshëm të sigurimit të cilësisë, përfshirjen e studentëve, transparencën institucionale dhe përputhshmërinë e programeve dhe stafit akademik me standardet e akreditimit. Këto vizita synuan të mbështesin institucionet e arsimit të lartë në zbatimin e procedurave të monitorimit dhe në forcimin e praktikave të brendshme të sigurimit të cilësisë.

6.3.4. Takimi informues me institucionet e arsimit të lartë për procedurat pas-akredituese

Agjencia e Kosovës për Akreditim organizoi një takim informues me institucionet e arsimit të lartë lidhur me Procedurat Pas-Akredituese dhe zbatimin e rekomandimeve të dala nga proceset e akreditimit. Në takim morën pjesë përfaqësues të institucioneve të arsimit të lartë, përfshirë koordinatorë të cilësisë dhe drejtues të programeve studimore. Gjatë këtij aktiviteti u prezantuan metodologjia dhe afatet e procedurave pas-akredituese, si dhe gjetjet kryesore nga analiza e Planeve të Zbatimit të Rekomandimeve të dorëzuara nga institucionet e arsimit të lartë. Diskutimet u fokusuan në rolin e institucioneve në këtë proces dhe në rëndësinë e zbatimit sistematik të rekomandimeve për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Takimi kontribuoi në rritjen e

transparencës dhe koordinimit ndërmjet Agjencisë dhe institucioneve të arsimit të lartë në zbatimin e procedurave pas-akredituese.

6.4. Zhvillimi i kuadrit rregullativ, politikave dhe kapaciteteve institucionale

Zhvillimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i kuadrit rregullativ dhe politikave institucionale përbën një element kyç për funksionimin efektiv të sistemit të sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë. Në këtë drejtim, Agjencia e Kosovës për Akreditim ka ndërmarrë aktivitete që synojnë përditësimin e akteve rregullative, forcimin e transparencës institucionale dhe harmonizimin e proceseve të saj me standardet evropiane të sigurimit të cilësisë. Po ashtu, janë zhvilluar iniciativa për ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe organizative të institucionit, me qëllim përmirësimin e efikasitetit dhe cilësisë së proceseve të akreditimit dhe monitorimit.

6.4.1. Konsultime publike për hartimin dhe përmirësimin e akteve rregullative të AKA-së

Agjencia e Kosovës për Akreditim, me qëllim të përmirësimin të vazhdueshëm të kornizës rregullatore dhe harmonizimit të proceseve të sigurimit të cilësisë me standardet ndërkombëtare, organizon në mënyrë të rregullt procese të konsultimit publik për aktet rregullative që lidhen me funksionimin e sistemit të sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë. Gjatë vitit raportues është zhvilluar procesi i konsultimit publik për Draft Rregulloren për Procedurat dhe Kriteret e Vlerësimit të Jashtëm nga Agjencitë Ndërkombëtare të Akreditimit, e cila është miratuar për diskutim publik nga KShC, në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 08/L-110 për AKA-në. Përmes këtij procesi, AKA ka ftuar institucionet e arsimit të lartë dhe palët e tjera të interesit që të kontribuojnë me komente dhe sugjerime lidhur me përmbajtjen e këtij akti rregullativ. Konsultimet publike synojnë rritjen e transparencës dhe përfshirjen e komunitetit akademik dhe të aktorëve të tjerë relevantë në zhvillimin e politikave dhe rregulloreve që lidhen me sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë.

6.4.2. Përmirësimi i kornizës rregullative dhe etike për funksionimin e AKA-së

Me qëllim të forcimit të standardeve institucionale dhe përmirësimin të proceseve të sigurimit të cilësisë, Agjencia e Kosovës për Akreditim ka zhvilluar një punëtori për hartimin e Rregullores për Procedurat e Përgjithshme në AKA, si dhe për rishikimin e Kodit të Etikës për stafin e institucionit. Rregullorja për Procedurat e Përgjithshme synon të standardizojë dhe të harmonizojë procedurat që

lidhen me funksionimin e AKA-së dhe me proceset e akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të studimit në Republikën e Kosovës. Përmes këtij dokumenti synohet krijimi i një kornize të qartë dhe transparente për zhvillimin e proceseve të akreditimit dhe aktiviteteve të tjera që lidhen me sigurimin e cilësisë, në përputhje me standardet dhe praktikat ndërkombëtare në këtë fushë. Në të njëjtën kohë, është shqyrtuar edhe rishikimi i Kodit të Etikës për stafin e AKA-së, i cili bazohet në Kodin e Shërbimit Civil të Republikës së Kosovës dhe përfshin parime që lidhen me integritetin dhe etikën profesionale në ushtrimin e funksioneve publike. Ky dokument përcakton standardet e sjelljes dhe përgjegjshmërisë profesionale që duhet të respektohen nga nëpunësit civilë të AKA-së gjatë ushtrimit të detyrave të tyre.

Përmes përditësimit të këtyre akteve rregullative dhe etike, AKA synon të forcojë transparencën institucionale, të rrisë besueshmërinë e proceseve të akreditimit dhe të kontribuojë në përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit të sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë në Republikën e Kosovës.

6.4.3. Dëgjimi publik për rishikimin e standardeve të studimeve të doktoratës

Agjencia e Kosovës për Akreditim ka organizuar një dëgjim publik për rishikimin e standardeve të studimeve të doktoratës (PhD), me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të institucioneve të arsimit të lartë dhe ekspertëve të fushës. Ky aktivitet u zhvillua me qëllim të përmirësimit të kornizës së vlerësimit të programeve të doktoratës dhe forcimit të mekanizmave të sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë në Republikën e Kosovës. Gjatë këtij procesi u diskutuan propozimet për përditësimin e standardeve që rregullojnë organizimin dhe vlerësimin e programeve të doktoratës, duke marrë parasysh zhvillimet në kërkimin shkencor, nevojën për mbikëqyrje cilësore akademike dhe përputhshmërinë me praktikat ndërkombëtare të sigurimit të cilësisë. Organizimi i këtij dëgjimi publik synoi përfshirjen e komunitetit akademik dhe të palëve të interesit në procesin e rishikimit të standardeve, duke siguruar që korniza rregullative për studimet e doktoratës të jetë e përshtatur me kërkesat e zhvillimit të kërkimit shkencor dhe me standardet evropiane të sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë. Ky aktivitet kontribuoi në forcimin e transparencës dhe në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programeve të doktoratës në institucionet e arsimit të lartë në Kosovë.

6.4.4. Punëtorja për hartimin e Strategjisë së AKA-së

Agjencia e Kosovës për Akreditim ka organizuar një punëtori për hartimin e Strategjisë së AKA-së për periudhën 2026–2030, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të Këshillit Shtetëror të Cilësisë dhe

stafit të agjencisë. Ky aktivitet kishte për qëllim përcaktimin e objektivave strategjike dhe prioriteteve institucionale për zhvillimin e mëtejshëm të sistemit të sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë në Republikën e Kosovës. Gjatë punëtorisë u diskutuan drejtimet kryesore të zhvillimit të AKA-së për periudhën e ardhshme, përfshirë forcimin e mekanizmave të akreditimit dhe monitorimit, zhvillimin e kapaciteteve institucionale dhe avancimin e bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e sigurimit të cilësisë. Hartimi i kësaj strategjie kishte për qëllim të sigurojë një qasje të strukturuar afatgjatë për përmirësimin e proceseve të vlerësimit dhe akreditimit, në përputhje me Standardet dhe Udhëzimet Evropiane për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ESG) dhe me zhvillimet bashkëkohore në arsimin e lartë. Ky aktivitet kontribuoi në forcimin e planifikimit strategjik të AKA-së dhe në avancimin e vazhdueshëm të mekanizmave të sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë në Kosovë.

6.4.5. Forcimi i integritetit institucional dhe transparencës në proceset e sigurimit të cilësisë

Agjencia e Kosovës për Akreditim ka miratuar Planin e Integritetit, i cili synon forcimin e transparencës institucionale, përgjegjshmërisë dhe standardeve etike në funksionimin e agjencisë. Ky dokument përcakton masat dhe mekanizmat për identifikimin dhe menaxhimin e rreziqeve që mund të ndikojnë në integritetin institucional dhe në proceset e vendimmarrjes.

Plani i Integritetit përfshin masa për parandalimin e konfliktit të interesit, rritjen e transparencës në proceset administrative dhe forcimin e përgjegjshmërisë institucionale. Përmes zbatimit të këtij plani synohet të garantohet një nivel i lartë integriteti në proceset që lidhen me akreditimin dhe sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë. Ky aktivitet kontribuoi në përmirësimin e qeverisjes institucionale dhe në forcimin e besueshmërisë së proceseve të sigurimit të cilësisë, duke mbështetur zhvillimin e një sistemi transparent dhe të qëndrueshëm të akreditimit në Republikën e Kosovës.

6.4.6. Miratimi i Politikave të Privatësisë

Agjencia e Kosovës për Akreditim miratoi Politikën e Privatësisë, një dokument institucional që përcakton mënyrën e mbledhjes, përpunimit dhe mbrojtjes së të dhënave personale në përputhje me Ligjin Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe legjislacionin përkatës të Bashkimit Evropian. Dokumenti përcakton procedurat për mbledhjen, përdorimin, ruajtjen dhe shpërndarjen e të dhënave personale, si dhe të drejtat e individëve për qasje, përditësim dhe paraqitje të ankesave

në rast të shkeljes së privatësisë. Në kuadër të tij parashihet edhe emërimi i zyrtarit përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave personale dhe bashkëpunimi me Agjencinë për Informim dhe Privatësi.

Miratimi i këtyre politikave kontribuoi në forcimin e transparencës institucionale, menaxhimin e sigurt të të dhënave dhe përputhshmërinë e proceseve të Agjencisë me standardet e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë.

6.4.7. Plani i zhvillimit profesional të stafit të AKA-së (2026–2028)

Në kuadër të aktiviteteve për forcimin e kapaciteteve institucionale dhe përmirësimin e proceseve të sigurimit të cilësisë, Agjencia e Kosovës për Akreditim miratoi Planin e zhvillimit profesional për stafin për periudhën 2026–2028. Ky dokument synon zhvillimin e kompetencave profesionale dhe teknike të stafit përmes trajnimeve, punëtorive të brendshme dhe pjesëmarrjes në aktivitete profesionale në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Plani përfshin aktivitete që lidhen me avancimin e njohurive në proceset e akreditimit, monitorimit dhe procedurave pas-akredituese, si dhe me përdorimin e platformave digjitale dhe analizën e të dhënave në funksion të përmirësimit të proceseve të punës. Në të njëjtën kohë, plani mbështet zhvillimin e aftësive profesionale të stafit në përputhje me standardet evropiane të sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë. Zbatimi i këtij plani pritet të kontribuojë në rritjen e efikasitetit institucional dhe në përmirësimin e mëtejshëm të proceseve të sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë në Republikën e Kosovës.

6.4.8. Zhvillimi i ueb-faqes së re të AKA-së në bashkëpunim me Agjencinë ADA

Agjencia e Kosovës për Akreditim ka zhvilluar një punëtor në të cilën është miratuar dizajni dhe struktura e ueb-faqes së re të institucionit, me qëllim përmirësimin e transparencës dhe qasjes në informacion për institucionet e arsimit të lartë dhe për publikun e gjerë. Zhvillimi i kësaj platforme digjitale realizohet në kuadër të projektit HEI 25, i financuar nga Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA), dhe synon të avancojë komunikimin institucional dhe publikimin e informacionit që lidhet me proceset e akreditimit dhe sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë. Ueb-faqja e re do të ofrojë një strukturë më të qartë të përmbajtjes dhe qasje më të lehtë në dokumentet zyrtare, vendimet, standardet dhe raportet e AKA-së. Faqja e re zyrtare e AKA-së ofron një strukturë më të qartë dhe të organizuar të përmbajtjes, duke mundësuar qasje më të lehtë në dokumentet, standardet dhe

vendimet e agjencisë, si dhe duke rritur transparencën dhe informimin e institucioneve të arsimit të lartë, publikut dhe partnerëve ndërkombëtarë mbi aktivitetet dhe proceset e sigurimit të cilësisë.

6.4.9. Trajnimi i institucioneve të arsimit të lartë për përdorimin e platformës digjitale

Agjencia e Kosovës për Akreditim realizoi një trajnim për përfaqësuesit e institucioneve të arsimit të lartë lidhur me përdorimin e platformës digjitale për aplikim në proceset e akreditimit. Në trajnim morën pjesë prorektorë dhe koordinatorë të cilësisë nga institucionet publike dhe private të arsimit të lartë në Republikën e Kosovës. Në kuadër të këtij aktiviteti u prezantuan funksionalitetet e sistemit elektronik që mundëson aplikimin online për akreditim dhe riakreditim institucional dhe të programeve të studimit, deklarimin e stafit akademik për programet përkatëse, si dhe ndërlidhjen me sistemet e institucioneve përkatëse shtetërore. Zbatimi i kësaj platforme kontribuoi në përmirësimin e administrimit të proceseve të akreditimit dhe në rritjen e efikasitetit, transparencës dhe menaxhimit të të dhënave në kuadër të sistemit të sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë, duke lehtësuar gjithashtu verifikimin dhe administrimin online të të dhënave nga ana e AKA-së dhe të institucioneve të arsimit të lartë.

6.4.10. Partneriteti dhe përkrahja nga donatorët

Gjatë vitit 2025, AKA ka vazhduar bashkëpunimin me programin Sustainable Higher Education and Research in Kosovo (SHER), i financuar nga ADA Austriake, i cili synon të mbështesë zhvillimin e një sektori të qëndrueshëm, të bazuar në dëshmi dhe të orientuar sipas nevojave në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor në Kosovë.

Në kuadër të këtij programi, AKA është një nga përfituesit e drejtpërdrejtë, ndërsa mbështetja përfshin forcimin institucional dhe përkrahjen për adresimin e kërkesave që lidhen me avancimin e pozitës së AKA-së në raport me standardet dhe mekanizmat evropianë të sigurimit të cilësisë.

Në këtë kuadër, SHER ka mbështetur AKA-në në procesin e hartimit të Planit Strategjik 2026–2030, përfshirë organizimin e punëtorive konsultative me palët e interesit, analizën SWOT dhe definimin fillestar të objektivave dhe masave strategjike. Po ashtu, ky bashkëpunim ka kontribuar edhe në organizimin e Konferencës së 3-të Vjetore për Arsimin e Lartë dhe Sigurimin e Cilësisë, e bashkëorganizuar nga AKA me mbështetjen e programit SHER, duke forcuar dimensionin

ndërkombëtar të veprimtarisë së Agjencisë dhe duke promovuar shkëmbimin e praktikave të mira në fushën e sigurimit të cilësisë.

Përmes këtij partneriteti, AKA ka përfituar mbështetje të rëndësishme në zhvillimin strategjik, forcimin e kapaciteteve institucionale dhe zgjerimin e bashkëpunimit ndërkombëtar, duke kontribuar kështu në avancimin e vazhdueshëm të rolit të saj në sistemin e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë në Republikën e Kosovës.

7. SFIDAT DHE PRIORITETET

7.1. SFIDAT

7.1.1 Sfida kryesore të AKA-së në vitin 2025 – Buxheti

Me hyrjen në fuqi të Ligjit të AKA-së, janë trefishuar detyrat dhe përgjegjësitë e AKA-së, pasi që më parë Agjencia ka pasur përgjegjësi vetëm për akreditimin, ndërsa me ligjin e ri janë shtuar detyrat e monitorimit dhe procedurave pasakredituese. Kostoja operative e AKA-së është rritur edhe për shkak të anëtarësimit në EQAR dhe organizata të tjera, pasi që në secilën organizatë ndërkombëtare ku jemi të anëtarësuar duhet paguar tarifa vjetore e anëtarësisë. Buxheti për shpenzime operative i AKA-së është rreth 1 milion euro, por kufiri i shpenzimeve të lejuara me Ligjin për Buxhetin është rreth 540 mijë euro. AKA ka të hyra rreth 1 milion euro në vit nga tarifatat për akreditim që paguajnë IAL-të, por këto të hyra, në tri vitet e fundit, kanë shkuar në thesarin e shtetit si suficit, për shkak të tavanit të shpenzimeve prej 540 mijë eurosh. Për të mbuluar hendekun financiar, në vitin 2025, Ministria e Financave, me vendim të Qeverisë, ka alokuar 80 mijë euro shtesë për AKA-në, por ende ka obligime të papaguara. Nëpërmjet rishikimit të buxhetit 2026, është e domosdoshme që të rritet kufizimi i shpenzimeve operative për AKA-në, në mënyrë që të sigurohet shfrytëzimi i buxhetit vetanak për mbulimin e kostove operative.

7.2. PRIORITETET

7.2.1. Implementimi i Rekomandimeve të EQAR

Raporti i vlerësimit të jashtëm për AKA-në ka identifikuar disa fusha prioritare për veprim të mëtejshëm, ndër të cilat: hartimin e një plani shumëvjeçar të zbatimit të Planit Strategjik, zhvillimin

më të rregullt të analizave tematike, planifikimin më të qartë të burimeve njerëzore, forcimin e sigurimit të brendshëm të cilësisë, përfshirjen më të strukturuar të studentëve dhe palëve të tjera të interesit, përmirësimin e proceseve të monitorimit dhe procedurave pasakredituese.

Këto rekomandime përbëjnë bazë të rëndësishme orientuese për avancimin institucional të AKA-së dhe për përafrimin e plotë me Standardet dhe Udhëzimet Evropiane për Sigurimin e Cilësisë (ESG). Në funksion të zbatimit të këtyre rekomandimeve, dokumentet strategjike të AKA-së parashohin masa konkrete që lidhen drejtpërdrejt me gjetjet e EQAR-it, përfshirë hartimin e politikës së sigurimit të brendshëm të cilësisë në AKA, realizimin e vetëvlerësimeve periodike, mbledhjen e rregullt të të dhënave nga palët e interesit, publikimin e përmbledhjeve të gjetjeve, hartimin e procedurave standarde të operimit, zgjerimin e përdorimit të platformave digjitale, prodhimin e analizave tematike vjetore, organizimin e konsultimeve me IAL-të dhe zhvillimin e trajnimeve për stafin dhe ekspertët.

Në këtë mënyrë, rekomandimet e vlerësimit të jashtëm janë reflektuar në drejtimet zhvillimore dhe në masat konkrete të punës së AKA-së.

7.2.2. Implementimi i Strategjisë së AKA-së 2026-2030

Strategjia e AKA-së 2026-2030 është ndërtuar mbi katër objektiva kryesore zhvillimore: zhvillimin e AKA-së si institucion me profesionalizëm dhe standarde të larta etike; avancimin e praktikave të sigurimit të cilësisë për përmirësim të vazhdueshëm në arsimin e lartë; ndërkombëtarizimin e sistemit të sigurimit të cilësisë; si dhe promovimin e kulturës së cilësisë në arsimin e lartë në Kosovë përmes ngritjes së vetëdijes, zhvillimit të kapaciteteve dhe institucionalizimit të praktikave të cilësisë. Strategjia gjithashtu e lidh zbatimin e saj me tema ndërsektoriale, si transformimi digjital, inteligjenca artificiale dhe zhvillimi i qëndrueshëm.

Implementimi i kësaj strategjie parasheh një qasje të strukturuar përmes masave, aktiviteteve dhe treguesve të matshëm. Në aspektin institucional, strategjia parasheh zhvillimin profesional të stafit, programe orientuese për anëtarët e rinj të KShC-së dhe stafin, forcimin e kapaciteteve menaxheriale dhe administrative, hartimin e politikës së sigurimit të brendshëm të cilësisë, zhvillimin e raporteve vjetore të performancës dhe procedurave standarde të operimit, si dhe rritjen e transparencës dhe komunikimit me publikun. Po ashtu, ajo synon digjitalizimin e plotë të proceseve të akreditimit, zgjerimin e përdorimit të të dhënave, prodhimin e analizave tematike, zgjerimin e rrjetit të ekspertëve

ndërkombëtarë, rishikimin e standardeve, si dhe organizimin e takimeve dhe punëtorive të rregullta me IAL-të për forcimin e cilësisë së brendshme.

Në tërësi, Strategjia e AKA-së 2026-2030 përbën dokumentin kryesor orientues për zhvillimin afatmesëm të Agjencisë, ndërsa zbatimi i saj synon ta forcojë AKA-në si institucion të pavarur, profesional dhe të besueshëm, duke kontribuar në përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit të sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë në Republikën e Kosovës dhe në përfrimin e mëtejme me praktikatat më të mira evropiane.

7. Referencat

Agjencia e Kosovës për Akreditim. *Kodi i Etikës për nëpunësit civil të AKA-së.*

<https://akreditimi.rks-gov.net>

Agjencia e Kosovës për Akreditim. *Manuali për zhvillimin profesional të stafit të ri.*

<https://akreditimi.rks-gov.net>

Agjencia e Kosovës për Akreditim. *Plani i Integritetit i AKA 2025–2027.*

<https://akreditimi.rks-gov.net>

Agjencia e Kosovës për Akreditim. *Politika e Privatësisë e AKA-së.*

<https://akreditimi.rks-gov.net>

Agjencia e Kosovës për Akreditim. *Politikat për sigurimin e brendshëm të cilësisë.*

<https://akreditimi.rks-gov.net>

Agjencia e Kosovës për Akreditim. *Rregullore për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të studimit në nivelin*

Bachelor dhe Master. <https://akreditimi.rks-gov.net>

Agjencia e Kosovës për Akreditim. *Rregullore për monitorim dhe procedura pas-akredituese.*

<https://akreditimi.rks-gov.net>

Agjencia e Kosovës për Akreditim. *Rregullore për organizimin dhe funksionimin e Këshillit*

Shtetëror të Cilësisë. <https://akreditimi.rks-gov.net>

Agjencia e Kosovës për Akreditim. *Rregullore për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin*

e vendeve të punës. <https://akreditimi.rks-gov.net>

Agjencia e Kosovës për Akreditim. *Rregullore për përzgjedhjen, angazhimin dhe kompensimin*

e ekspertëve të jashtëm. <https://akreditimi.rks-gov.net>

Agjencia e Kosovës për Akreditim. *Rregullore për procesin e vlerësimit të AKA nga institucionet e arsimit të lartë.* <https://akreditimi.rks-gov.net>

Agjencia e Kosovës për Akreditim. *Rregullore për punën e Komisionit të Ankesave.* <https://akreditimi.rks-gov.net>

Agjencia e Kosovës për Akreditim. *Rregullore për standardet e programeve të studimit PhD.* <https://akreditimi.rks-gov.net>

Agjencia e Kosovës për Akreditim. *Udhëzuesi për IAL-të për procesin e ankimimit në Komisionin e Ankesave.* <https://akreditimi.rks-gov.net>

Agjencia e Kosovës për Akreditim. *Udhëzuesi për procedurat e përgjithshme në AKA-në.* <https://akreditimi.rks-gov.net>

Central and Eastern European Network of Quality Assurance Agencies in Higher Education. *CEENQA.* <https://www.ceenqa.org>

Council of Europe. *Ethics, Transparency and Integrity in Education (ETINED).* <https://www.coe.int>

European Association for Quality Assurance in Higher Education. *Standards and Guidelines for Quality Assurance in the European Higher Education Area (ESG).* <https://www.enqa.eu>

European Quality Assurance Register for Higher Education. *EQAR.* <https://www.eqar.eu>

Global Academic Integrity Network. *GAIN.* <https://globalacademicintegrity.network>

International Network for Quality Assurance Agencies in Higher Education. *INQA/AHE.* <https://www.inqahe.org>

Kuvendi i Republikës së Kosovës. *Ligji Nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës.*

<https://gzk.rks-gov.net>

Kuvendi i Republikës së Kosovës. *Ligji Nr. 08/L-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim.*

<https://gzk.rks-gov.net>

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit. *Udhëzim Administrativ për vlerësimin e përshtatshmërisë së bartësve të programeve studimore dhe programeve nga radhët e komuniteteve jo shumicë në procesin e akreditimit dhe riakreditimit të institucioneve të arsimit të lartë.* <https://masht.rks-gov.net>